



Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut

ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE LOKALE

22 mars dhe 5 prill 2009

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR –it për vëzhgimin e zgjedhjeve



Varshavë
30 qershor 2009

PËRMBAJTJA:

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALËNDERIME	4
III.	KONTEKSTI POLITIK	5
IV.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR	6
A.	SISTEMI ZGJEDHOR	7
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	7
A.	HISTORIATI	7
B.	ADMINISTRIMI I RRETHIT TË PARË	8
C.	ADMINISTRIMI I RRETHIT TË DYTË	9
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	9
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	10
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE	10
A.	FINANCIMI I FUSHATËS	14
IX.	MEDIAT	15
A.	HISTORIATI.....	15
B.	KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT	15
C.	MBIKQYRJA E MEDIAVE NGA MVZ I OSBE/ODIHR-IT.....	16
X.	PJESËMARRJA E FEMRAVE	18
XI.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	20
XII.	VËZHGESIT VENDORË	21
XIII.	ANKESAT DHE APELET	21
XIV.	VOTIMI, PËRLLLOGARITJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE	22
A.	DITA E VOTIMIT - RRETHI I PARË	22
B.	DITA E VOTIMIT - RRETHI I DYTË	23
C.	PËRLLLOGARITJA - RRETHI I PARË	24
D.	PËRLLLOGARITJA - RRETHI I DYTË	24
E.	SHPALLJA E REZULTATEVE	24
XV.	DITA E ZGJEDHJEVE NË ASPEKT TË ANKESAVE DHE APELEVE	25
XVI.	REKOMANDIMET	26
A.	BALLAFAQIMI ME PRESIONIN OSE FRIKËSIMIN E VOTUESVE.....	26
B.	KORNIZA LIGJORE.....	27
C.	ADMINISTRATA ZGJEDHORE	28
D.	REGJISTRIMI I VOTUESVE.....	29
E.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	29
F.	FUSHATA ZGJEDHORE.....	29
G.	MEDIAT	29
H.	VOTIMI, NUMËRIMI, PËRLLLOGARITJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE	30
I.	ANKESAT DHE APELET	30
J.	PJESËMARRJA E FEMRAVE	31
K.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	31
L.	VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE.....	31
	ANEKS: REZULTATET E ZGJEDHJEVE	33
	RRETH OSBE/ODIHR-SË	35

ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE LOKALE
22 mars dhe 5 prill 2009

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR –it për vëzhgim të zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Pas pranimit të ftesës nga Ministria e punëve të jashtme për të vëzhguar zgjedhjet presidenciale dhe lokale të vitit 2009, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) themeloi misionin për vëzhgim të zgjedhjeve (MVZ) në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Me qëllim të vëzhgimit të ditës së zgjedhjeve më 22 mars, OSBE/ODIHR-ja i bashkoi forcat me delegacionet vëzhguese të Kuvendit Parlamentar të OSBE-së (OSBE KP), Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës (KPKE) dhe me Kongresin e autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) dhe formoi Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgim të Zgjedhjeve (MNVZ). Me qëllim të vëzhgimit të rrethit të dytë të zgjedhjeve më 5 prill, MVZ i OSBE/ODIHR i bashkoi forcat me Delegacionin vëzhgues të KPKE-së. Këto zgjedhje vlerësoheshin për përputhshmërinë e tyre me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendor.

Dy rrethet e zgjedhjeve presidenciale dhe lokale i plotësuan shumicën e përkushtimeve të OSBE-së dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Roli konstruktiv dhe diskret, por në të njëjtën kohë sigures i prezencës së policisë solli deri tek mbajtja e zgjedhjeve të qeta. Gjithashtu u vërejt një progres kuptimplotë siç është sjellja e përgjegjshme e partive politike dhe përpjekjet e dukshme në përdorimin e retorikës së matur gjatë fushatës. Përgjithësisht, këto zgjedhje u administruan në mënyrë profesionale dhe transparente. Disa probleme ishin të dukshme, siç ishin informatat për frikësimin e votuesve gjatë periudhës parazgjedhore.

Korniza ligjore për zgjedhjet presidenciale dhe lokale është konsoliduar me Kodin zgjedhor të miratuar në vitin 2006, dhe të ndryshuar për herë të fundit në tetor të vitit 2008. Amendamentet e fundit adresuan disa rekomandime të propozuara nga OSBE/ODIHR pas zgjedhjeve të vitit 2008. Kodi zgjedhor ende përmban dispozita të cilat janë joprecize dhe u mungojnë hollësi; kjo nuk kompensohet me rregullativa adekuate. Boshllëqet lënë hapësirë për interpretime konfliktuoze ose aplikim të ndryshueshëm.

Në këto zgjedhje, Kryetari i shtetit u zgjodh me sistem dy-rrethor, me kriter për dalje të votuesve në zgjedhje gjatë rrethit të dytë. Kushtetuta u ndërrua në janar të vitit 2009 për të ulur kriterin e përqindjes për dalje në zgjedhjet presidenciale gjatë rrethit të dytë prej më 50% nga votuesit e regjistruar në 40%. 85 kryetarët e komunave u zgjodhën me sistem dy-rrethor, me kriter gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve, kurse këshillat komunale u zgjodhën me sistem të përfaqësimit proporcional.

Zgjedhjet u administruan me një administratë në tre nivele, e përbërë nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KSHZ), 84 komisione komunale zgjedhore (KKZ) dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, dhe 2976 Këshille Zgjedhore (KZ). Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë të tjerë u emëruan nga opozita, kurse zëvendës Kryetari dhe tre anëtarë të tjerë nga partitë qeveritare. Anëtarët e KKZ-ve dhe shumica e anëtarëve të KZ-ve u zgjodhën në mënyrë të rastësishme

¹ Ky raport është gjithashtu në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Mirëpo, verzioni në anglisht mbetet i vetmi dokument zyrtar.

nga nëpunësit shtetëror. Si ndryshim nga zgjedhjet e fundit, përbërja e KZ-ve u ndryshua në një model të përzier politiko-profesional, ku një pjesë e anëtarësisë u caktua nga partitë politike.

Në përgjithësi, përgatitjet për zgjedhjet e 22 marsit u zhvilluan në mënyrë të qetë dhe u realizuan përbrenda afateve ligjore, edhe pse KSHZ-ja u pengua në punën e saj nga mungesa e stafit ndihmës të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në numër. KSHZ-ja u tregua se gëzon besimin e shumicës së kandidatëve dhe partive politike. Deri tek mbajtja e rrethit të parë, KSHZ-ja funksionoi në mënyrë transparente dhe në frymën e konsensusit. Gjatë periudhës në mes dy rretheve zgjedhore, fryma e kolegjalitetit herë pas here u zëvendësua me interesat partiake, kështuqë punës së KSHZ-së disa herë i mungonte transparenca.

Rreth 1, 8 milion qytetarë kishin të drejtë të votojnë gjatë këtyre zgjedhjeve, marrë nga numri i popullatës prej 2, 04 milion. Këto numra gjithë kohës shpinin kah dyshimet e vazhdueshme ndaj vërtetësisë së listave të votuesve. Rekomandimet e kamotshme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Vendikut për një revidim të tërësishëm të listave votuese mbetën që të adresohen.

Shtatë kandidatë presidencial, 364 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 702 lista për këshilltarë komunal u regjistruan gjatë një procesi gjithëpërfshirës, duke u dhënë votuesve zgjedhje të gjerë. Edhe pse procedura për mbledhjen e nënshkrimeve për të mbështet kandidaturën konsiderohet si shumë restriktive dhe e vështirë, në praktikë sistemi nuk e parandaloi regjistrimin e kandidatëve të fushave të ndryshme.

Periudha 19 ditore e fushatës zyrtare parazgjedhore para rrethit të parë zgjedhor ishte shumë e gjallë dhe shumë e pranishme, në të cilën partitë politike dhe kandidatët presidencialë u angazhuan në një program vullshëm të tubimeve. Përpara se të fillojë fushata zyrtare, mungesa e rregullave të qarta ligjore se cilat aktivitete ishin të lejueshme, rezultoi në paqartësi. Fushata gjatë periudhës midis dy rretheve zgjedhore ishte më e qetë. Në përgjithësi, çështjet lokale ishin më dominuese se sa çështjet nacionale gjatë fushatës.

Partitë dhe kandidatët u betuan se do të mbajnë zgjedhje të qeta dhe do t'i shmangen çdo lloji të incidenteve të dhunshme të cilat i njollosën zgjedhjet e vitit 2008. Përprjekjet e tyre në përgjithësi u treguan të suksesshme dhe vetëm një numër i vogël i incidenteve u raportuan, edhe pse tensionet ishin të larta në disa komuna. Gjatë periudhës parazgjedhore u mbajtën edhe disa takime të liderëve të partive më të mëdha me qëllim që të promovojnë qasje të qetë dhe bashkëpunuese për zgjedhjet. Policia luajti rol konstruktiv në sigurimin e atmosferës së qetë, në veçanti gjatë dy ditëve të zgjedhjeve.

Me disa përjashtime, kandidatët presidencial dhe lokal garuan kryesisht në bashkësitë e tyre etnike. Modeli i votimit në bazë etnike posaçërisht u bë i qartë gjatë rrethit të dytë, kur përqindja e daljes në zgjedhjet presidenciale ishte veçanërisht e ulët në vendet e dominuar me shqiptarë etnik.

Çështja më shqetësuese në lidhje me zgjedhjet ishin pohimet e shumta, shqetësuese dhe të besueshme nga mbarë vendi për presion ose frikësim të qytetarëve. Kjo gjë seriozisht e zvogëloi kualitetin e përgjithshëm të procesit zgjedhor. U tregua se nëpunësit e sektorit publik ishin posaçërisht të pambrojtur nga kërcënimet se vendet e tyre të punës do të vihen në rrezik nëse ato nuk e përkrahnin partinë qeveritare. Informata të tjera të pavërtetuara thoshin se qytetarët janë kërcënuar se do t'i humbin pensionet ose shërbimet sociale, nëse do të përkrahnin ose nuk do të përkrahnin ndonjërin nga partitë ose kandidatët. Pjesa dërmuese e

këtyre pohimeve kishin të bëjnë me veprime të zyrtarëve shtetëror dhe aktivistëve të partive qeveritare. Kryeministri dha deklarata të fuqishme publike, por të vonshme, kudër këtyre praktikave të cilat nuk ishin të mjaftueshme për tu dhënë fund presioneve dhe frikësimeve ose për të kthyer besimin e plotë publik.

Shteti disponon me një sërë mediash të ndryshme emituese dhe të shtypit. Qeveria është reklamuesi më i madh dhe i vetëm, gjë që e bën atë të ketë ndikim të konsiderueshëm mbi shumë media. Trupi kryesor rregullator, Këshilli për radiodifuzion (KR), funksionoi në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Ai solli rregulla për mbulimin mediatik para dhe gjatë periudhës së fushatës zyrtare; të parët u kritikuan si shumë restriktiv nga disa media kombëtare.

Gjatë fushatës zyrtare, mediat u siguruan votuesve llojlojshmëri të pikpamjeve politike. Pati disa debate mes kandidatëve presidencialë. Televizioni publik i Maqedonisë (TVM) u siguroi kandidatëve kohë emitimi pa pagesë. Përgjithësisht, mediat e emitimit, megjithëse në të shumtën e rasteve jo plotësisht të balancuara, mundësuan mbulim adekuat të garuesve në zgjedhje. Mediat e shkruara siguruan një llojlojshmëri të pikëpamjeve; përgjithësisht mbulimi i tyre i aktorve politik ishte më kritik se ai i mediave emituese.

Një femër ishte kandidatë për president – e para në këtë shtet – megjithatë kishte vetëm 13 femra në mesin e 364 kandidatëve për kryetarë komune, dhe asnjëra prej tyre nuk u zgjodh. Kriteri ligjor që së paku një nga tre vende në listat e kandidatëve patjetër të jetë rezervuar për gjininë “më pak të përfaqësuar”², rezultoi në zgjedhjen e femrave në 27% të posteve në këshillat komunal. Partitë politike nuk u treguan se bënë përpjekje të veçanta për të fituar votat e grave, dhe gratë ishin dukshëm më pak të pranishme se burrat në shumicën e tubimeve politike. Kriteri ligjor që çdo gjini të përbëjë 30% të organeve për menaxhim të zgjedhjeve u përmbush, përveç se në anëtarësinë e KSHZ-së. Votimi familjar vazhdoi të mbetet problem, edhe përkaj fushatave për edukim të votuesve kundër tij.

Kërkesat ligjore për përfaqësim “adekuat dhe të barabartë”³ të bashkësive etnike në administrimin e zgjedhjeve në zonat ku ata përbëjnë së paku 20% të popullatës, u përmbushën. Përveç kësaj, pati 33 kandidatë për kryetarë të komunave nga bashkësitë që nuk u takojnë maqedonasve etnik ose shqiptarëve etnik, shumica prej tyre garonin për parti që përfaqësonin komunitetin e tyre. Pesë nga ta u zgjodhën. Tensionet ishin të larta në disa fushata, veçanërisht në komunat ku kundërshtarët kryesorë i takonin të njejtës bashkësi etnike.

U akredituan rreth 7 mijë vëzhgues vendorë, jo partiak, duke i shtuar procesit zgjedhor një element të rëndësishëm transparence. Grupi më i madh vëzhgues vendorë ishte ai i Asociacionit qytetar MOST, i cila akreditoi mbi 4 500 vëzhgues.

Kodi Zgjedhor i ndryshuar ofron një kornizë më të zhvilluar për ankesa dhe apele, megjithëse u vërejt se afatet mbetën të shkurtra dhe me mangësi dhe ndryshueshmëri në vendimmarrje. Në procesimin e ankesave, KSHZ-ja e interpretoi shumë ngushtë obligimin e vet në lidhje me kontrollimin e materialit zgjedhor, dhe pati disa ndryshueshmëri në atë se a duhet të kontrollohet i gjithë materiali zgjedhor apo jo. KSHZ-ja poashtu ishte e paafte të procesojë ankesat e rrethit të parë zgjedhor brenda afateve ligjore, gjë që vonoi shpalljen e rezultateve përfundimtare për rrethin e parë dhe i komplikoi përgatitjet për rrethin e dytë. Gjykata Administrative mbështeti vetëm një nga 100 proceset gjyqësore kundër vendimeve të KSHZ-

² Kodi zgjedhor, Neni 54 (5)

³ Kodi zgjedhor, Neni 21 (1)

së për të dy rrethet, në seanca kryesisht të mbyllura për publikun, edhe përkaj kërkesave ligjore për të vendosur në seanca publike.

Rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale u mbajt më 5 prill, meqë asnjëri prej kandidatëve nuk mori mbështetjen e mbi 50% të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar, e cila është kërkesë ligjore për t'u zgjedhur në rrethin e parë. Rreth i dytë i zgjedhjeve u mbajt më 5 prill edhe për 44 nga 85 postet për kryetarë komune. Përveç se votimit në rrethin e dytë, vendvotimet në 8 komuna mbajtën rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetarë komune, dhe vendvotimet e 23 komunave mbajtën zgjedhje për këshillat komunal më 5 prill, ose për shkak se rezultatet u anuluan, ose për shkak se vendvotimet nuk mundën të hapen si rrjedhojë e motit të lig më 22 mars. Votim i mëtejshëm u mbajt më 19 prill dhe 3 maj.

Edhe dita e zgjedhjeve më 22 mars, edhe ajo më 5 prill ishin përgjithësisht të qeta dhe paqësore. Në asnjërin prej rretheve zgjedhore nuk u raportuan instanca të dhunës ose incidente të mëdha, dhe tensionet ishin të dukshme vetëm në disa vende. Gjatë të dy rretheve zgjedhore, u vërejt vetëm numër i kufizuar i instancave më serioze të parregullsive zgjedhore. Në përgjithësi, vëzhguesit e MVZ-së e vlerësuan rrethin e dytë si më pozitiv se të parin. Ato e vlerësuan procesin e votimit si “të mirë” ose “shumë të mirë” (në 95% të vendvotimeve të vizituara gjatë rrethit të parë, dhe 97% në rrethin e dytë), dhe e përshkruan atë si përgjithësisht të organizuar mirë, në qetësi dhe me rregull. Vlerësimi ishte më negativ gjatë rrethit të parë në komunat e dominuara me shqiptarë etnik se sa në pjesën tjetër të vendit; mirëpo nuk pati kësi dallimesh në rrethin e dytë. Prezenca e policisë u konsiderua si e organizuar mirë dhe diskrete.

Numërimi i votave u vlerësua më pak pozitiv se sa votimi gjatë dy rretheve. 15% nga 116 numërimet e vëzhguara gjatë rrethit të parë u vlerësuan si negative, kurse 9% nga 61 numërimet e vëzhguara gjatë rrethit të dytë u vlerësuan si negative. Problemet kryesisht kishin të bëjnë me mosrespektimin e procedurave themelore, përfshirë edhe përputhshmërinë e rezultateve. Gjysma e KZ-ve gjatë rrethit të parë dhe më shumë se gjysma e tyre gjatë rrethit të dytë ku u vëzhgua numërimi nuk postuan kopje të rezultateve për njoftim të publikut. Procesi i përlllogaritjes tek KKZ-të u vlerësua përgjithësisht pozitiv gjatë të dy rretheve. U vërejtën disa çeshtje që kanë të bëjnë me transparencën gjatë përlllogaritjes së të dy rretheve, kryesisht në lidhje me aftësinë e vëzhguesve për të vëzhguar futjen e të dhënave nga rezultatet. Gjatë rrethit të dytë pati një numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, që paraqiste 5.96% të numrit të përgjithshëm të votuesve që kishin dalë në votime. Dalja në votime gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale ishte 56, 88 %, kurse gjatë rrethit të dytë kjo përqindje ra në 42, 63%.

Ky raport ofron rekomandime për shqyrtim nga autoritetet në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. OSBE/ODIHR është e gatshme t'i mbështesë edhe më tej përpjekjet e autoriteteve, partive politike dhe shoqërisë civile në shqyrtimin e sfidave që kanë mbetur.

II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Pas pranimit të ftesës nga Ministria e punëve të jashtme e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për të vëzhguar zgjedhjet presidenciale dhe lokale të vitit 2009, OSBE/ODIHR themeloi Mision për vëzhgim të zgjedhjeve më 13 shkurt 2009. MVZ i OSBE/ODIHR-it u kryesua nga z. Peter Eicher dhe përbehej nga 16 ekspertë dhe 23 vëzhgues afatgjatë (VAF) nga 25 shtete pjesëmarrëse në OSBE, të cilët u vendosën në Shkup dhe në dhjetë qendra rajonale.

Me qëllim të vëzhgimit të ditës së zgjedhjeve më 22 mars, OSBE/ODIHR-it i bashkoi forcat me delegacionet vëzhguese të Kuvendit Parlamentar të OSBE-së (OSBE KP), Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës (KPKE) dhe me Kongresin e autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) dhe formoi Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgim të Zgjedhjeve (MNVZ). Z-nja Pia Christmas-Møller udhëhoqi Delegacionin e OSBE KP dhe u emërua nga Kryesuesi aktual i OSBE-së, Koordinatore Speciale që të udhëheqë me misionin vëzhgues afatshkurtër. Z-nja Marietta de Pourbaix-Lundin udhëhoqi Delegacionin e KPKE-së, kurse z-nja Ludmila Sfirloaga udhëhoqi Delegacionin e Kongresit. Për vëzhgimin e rrethit të dytë të zgjedhjeve më 5 prill, KPKE-ja emëroi përfaqësues z. Jørgen Poulsen të jetë prezent në shtet; KPKE-ja gjithashtu iu bashkua OSBE/ODIHR-it gjatë daljes së deklaratës preliminare pas rrethit të dytë të zgjedhjeve.

Për rrethin e parë të zgjedhjeve, MNVZ-ja angazhoi rreth 320 vëzhgues prej 40 shteteve pjesëmarrëse në OSBE, duke përfshirë edhe 245 vëzhgues afatshkurtër të angazhuar nga OSBE/ODIHR- dhe të emëruar nga vendet pjesëmarrëse në OSBE, të cilët vëzhguan votimin në 1062 vendvotime, dhe procesin e numërimit në 116 vendvotime. MNVZ-ja gjithashtu vëzhgoi procesin e përlllogaritjes në 44 nga 85 KKZ. Në rrethin e dytë, MVZ i OSBE/ODIHR-it angazhoi 132 vëzhgues afatshkurtër, të cilët e vëzhguan procesin e votimit në 778 vendvotime dhe numërimin në 61 vendvotime, si dhe përlllogaritjen në 39 KKZ.

MVZ i OSBE/ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendor. Ky raport përfundimtar vjen pas deklaratave për vlerësimet dhe konkluzionet preliminare të cilat u publikuan gjatë konferencave për shtyp më 23 mars dhe 6 prill 2009.⁴

MVZ i OSBE/ODIHR falënderon Ministrinë e punëve të jashtme, Komisionin shtetëror zgjedhor, autoritetet, partitë politike dhe shoqërinë civile në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për bashkëpunimin e tyre. MVZ i OSBE/ODIHR gjithashtu dëshiron të shprehë mirënjohje Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup, dhe Misioneve diplomatike të shteteve pjesëmarrëse në OSBE dhe organizatave ndërkombëtare të vendosura në këtë shtet për mbështetjen e dhënë.

III. KONTEKSTI POLITIK

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është Republikë parlamentare, me pushtetin legjislativ në duart e 120 deputetëve dhe pushtetin ekzekutiv të ushtruar nga Qeveria, të udhëhequr nga Kryeministri. Presidenti ka kompetenca të shërbejë si Gjeneral i forcave ushtarake, Kryetar i Këshillit për siguri, të dorëzojë emrin e Kryeministrit të emërtuar për votim në Parlament, emëron Ambasadorë, gjykatës, dhe shpall ligje. Që nga sjellja e ligjit për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale në vitin 2004, kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunal kanë fituar kompetenca të reja në fushat si planifikim të qytetit, arsim dhe mirëqenie.

Zgjedhjet presidenciale dhe lokale u caktuan për 22 mars 2009, në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Presidenti në pushtet Branko Cërvenkovski deklaroi se nuk do të kërkojë rizgjedhje dhe se do të kthehet në udhëheqësin e partisë së tij, në Lidhjen

⁴ Deklaratat preliminare janë në dispozicion në faqen e internetit të ODIHR-së: www.osce.org/odihr

socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM-së), edhe pse nuk iu ndalua të garojë për një mandat të dytë. Përveç kësaj, mandatet e 84 kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve komunal, dhe atij të Qytetit të Shkupit (i cili përbëhet prej 10 komunave), mbaruan në fund të muajit mars 2009.

Zgjedhjet presidenciale dhe lokale u mbajtën më pak se një vjet pas zgjedhjeve parlamentare të 1 qershor 2008, të cilat OSBE/ODIHR në Raportin përfundimtar konkludoi “në përgjithësi [...] nuk i plotësoi përkushtimet kyçe të OSBE-së”, vecanërisht për shkak të dhunës dhe parregullsisve. Pas këtyre zgjedhjeve, Organizata e brendshme revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike për unitet nacional maqedonas (VMRO-DPMNE) formoi koalicion qeveritar me Bashkimin demokratik për integrim (BDI) dhe me Partinë për ardhmëri evropiane (PAE); koalicioni përbën shumicën me 82 vende në Parlament.

IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Korniza ligjore për zgjedhjet presidenciale dhe lokale është e konsoliduar me Kodin Zgjedhor i cili u miratua në vitin 2006. Në tetor të vitit 2008, Parlamenti miratoi një numër të madh të amendamenteve të Kodit zgjedhor, kurse në janar të vitit 2009 Parlamenti miratoi edhe një amendament të Kushtetutës. Amendamenti kushtetues e zbriti kriterin e përqindjes së daljes në votim gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale prej 50% në 40%. Përderisa qëllimi i këtij kriteri ishte të sigurohet se të zgjedhurit në post përfaqësojnë një pjesë domethënëse të popullatës, ky lloj kriteri gjatë rrethit të dytë mund të shpij deri tek dështimi i zgjedhjeve. Amendamentet e Kodit zgjedhor përfshijnë më shumë dispozita specifike mbi financimin e fushatës dhe qartësimin e rolit dhe përgjegjësinë e organeve të ndryshme që mbajnë përgjegjësinë në procesimin e ankesave zgjedhore. Tek ndryshimet e tjera u përfshij edhe kthimi i përbërjes së organeve për administrim të zgjedhjeve nga profesionalisht të pastër në përbërje të përzier politiko-profesionale. Disa amendamente shtesë u lanë të implementohen në zgjedhjet e ardhshme, siç është mbartja e përgjegjësisë për përditësimin e listës votuese nga Ministria e drejtësisë tek KSHZ-ja, si dhe lejimi i qytetarëve që jetojnë jasht shtetit të votojnë në Ambasada gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare; që të dy do të hyjnë në fuqi më 1 shtator 2009.

Amendamentet e miratuara në tetor të vitit 2008 prekën disa rekomandime që u dhanë nga OSBE/ODIHR- pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008, si dhe rekomandime të propozuara nga OSBE/ODIHR dhe Këshilli i Evropës (KE) Komisioni i Venedikut në komentet e përbashkëta mbi legjislacionin zgjedhor⁵. Në këto ndryshime përfshihen edhe dispozitat e përmirësuara për zgjedhjen e kontesteve zgjedhore, dhe përmirësimin e rregullativave për financim të fushatës.

Gjithashtu pati disa rekomandime të OSBE/ODIHR-it të cilat nuk u implementuan ose u implementuan pjesërisht. Për shembull, përderisa rregullacioni për financimin e fushatës u përmirësua, ende vazhdon të mungojë mbikqyrja adekuate mbi financimin e fushatës dhe ende ka paqartësi në ligjin i cili i kufizoi donacionet e fushatave. Kodi elektoral ende përmban dispozita të cilat nuk janë precize dhe u mungojnë detaje, dhe në këtë mënyrë mbetet hapsirë për interpretime konfliktuoze ose implementim të ndryshueshëm. KSHZ-ja miratoi një numër udhëzimesh dhe rekomandime para zgjedhjeve të 2009-ës. Mirëpo, këto nuk i qartësuan plotësisht boshllëqet që ekzistojnë në Kodin zgjedhor.

⁵ OSBE/ODIHR dhe KE Komisioni i Venedikut Mendimet e përbashkëta mund të gendet në www.osce.org/odihr-elections/13441.html.

A. SISTEMI ZGJEDHOR

Presidenti zgjidhet me vota të drejtpërdrejta me mandat pesë vjeçar dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë. Që të fitojë në zgjedhje gjatë rrethit të parë të votimit, kandidati presidencial duhet të marrë votat e shumicës nga numri i regjistruar i votuesve. Nëse asnjëri kandidat nuk e plotëson këtë kriter, dy kandidatët me më shumë vota shkojnë në rrethin e dytë brenda dy javëve. Zgjidhet kandidati që merr shumicën e votave gjatë rrethit të dytë, me kusht që së paku 40% e votuesve të regjistruar të dalin në votim. Përndryshe, i gjithë procesi zgjedhor duhet të përsëritet.

Një kandidat për kryetar komune zgjidhet gjatë rrethit të parë të votimit nëse ai ose ajo fiton më shumë se 50% të votave, me kusht që së paku një e treta e votuesve të regjistruar në atë komunë të dalin në votime. Nëse nuk ka fitues gjatë rrethit të parë, rrethi i dytë mbahet brenda dy javëve midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Fitues në rrethin e dytë është kandidati i cili merr shumicën e votave, pa asnjë kriter për daljen e votuesve në votime. Këshilltarët komunal zgjidhen me sistem të përfaqësimit proporcional, me lista të mbyllura, pa kriter për daljen e votuesve në votime.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A. HISTORIATI

Zgjedhjet presidenciale dhe ato lokale të vitit 2009 u administruan me një administratë në tre nivele, e përbërë nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KSHZ), 84 komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, dhe 2976 Këshille Zgjedhore (KZ). Më 4 dhjetor të vitit 2008, dhe sic kërkohet me amendamentet e Kodit zgjedhor, përbërje e re e KSHZ-së u emërua nga Parlamenti. Emërimet u bënë gati një muaj para se të caktohen zgjedhjet, e cila periudhë në fakt është e shkurtër që të pritët nga një komision zgjedhor të organizojë veten dhe të funksionojë me efikasitet. Ky problem sado pak u lehtësua nga fakti se katër nga shtatë anëtarët e përbërjes së Komisionit të mëparshëm u riemëruan. Emërimet gjithashtu u vlerësuan në mesin e partive politike si pozitive, meqë emërimet i lejuan opozitës të mbushi pozitën e Kryetarit të KSHZ-së⁶.

Në zgjedhjet e vitit 2008, anëtarët e KZK-ve dhe shumica e anëtarëve të KZ-ve dhe zëvendësit e tyre u zgjodhën në mënyrë të rastësishme me anë të kompjuterit, nga mesi i nëpunsave shtetëror, administrata publike dhe komunale. Amendamentet e Kodit zgjedhor e kthyen përbërjen e KZ-ve në modelin e përzier politiko-profesional, me nga një anëtarë (dhe një zëvendës) për secilin KZ të emëruar nga partitë politike në opozitë, dhe një anëtarë (dhe një zëvendës) të emëruar nga partitë qeveritare. Pjesa tjetër e anëtarëve të KZ-ve u zgjodhën rastësisht si më parë. Përfshirja e anëtarëve të partive politike duket se ka rritur besimin e partive më të mëdha politike tek administrimi i zgjedhjeve, dhe poashtu ka lehtësuar vështirësitë në rekrutimin e një numri të madh të anëtarëve të KZ-ve (gjithsej 30 000, përfshirë këtu edhe zëvendësat) vetëm nga administrata.

⁶ Në bazë të Kodit zgjedhor, opozita emëron Kryetarin e KSHZ-së dhe dy anëtarë, dhe partitë qeveritare emërojnë zëvendës Kryetarin dhe tre anëtarë. Komisioni i mëparshëm u zgjodh para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 që e sollën VMRO-DPMNE-në në Qeveri, ku u krijua një situatë ku partitë qeveritare, në vend të opozitës kryesuan me KSHZ-në.

B. ADMINISTRIMI I RRETHIT TË PARË

Në përgjithësi, përgatitjet për zgjedhjet e 22 marsit u zhvilluan qetë dhe u implementuan brenda afateve ligjore, edhe pse KSHZ-ja u pengua në punën e vet nga mungesa e stafit mbështetës të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në numër, çështje kjo e përmendur nga OSBE/ODIHR-it dhe Komisioni i Venedikut të Këshillit të Evropës⁷. Në periudhën deri në rrethin e parë të zgjedhjeve, KSHZ-ja funksionoi në mënyrë transparente dhe në frymën e konsensusit, dhe u tregua se e gëzon besimin e shumicës së kandidatëve dhe partive politike.

Seancat e KSHZ-së ishin të hapura për vëzhguesit ndërkombëtar, vëzhguesit jopartiak vendor, përfaqësuesit e autorizuar të parashtuesve të listave⁸, dhe mediat. Mirëpo, KSHZ-ja shpesh mbajti seanca punuese të cilat jo gjithmonë ishin të paralajmëruara, gjë që i pengoi vëzhguesit të marrin pjesë. Edhe pse në bazë të Nenit 2 nga Rregullorja e brendshme e KSHZ-së (2006), KSHZ-ja mund të mbajë seanca që nuk janë të hapura për publikun, kjo praktikë e nënvleftësoi sado pak transparencën e punës së KSHZ-së.

Përkundër faktit që KSHZ-ja solli një numër të udhëzimeve dhe rregullave, ekzistonte mungesë e qartë e rregulloreve zgjedhore të hollësishme që do të siguronin praktika të qarta dhe konsistente, dhe që do të kompensojnë për paqartësinë e disa dispozitave të Kodit zgjedhor. KSHZ-ja miratoi Doracak për edukimin e organeve zgjedhore, por doracaku nuk i elaboronte në hollësi praktike procedurat zgjedhore, dhe nuk përfshinte udhëzime të hollësishme për përputhshmërinë e rezultateve dhe procedurave përlllogaritëse në nivel të KKZ-së.

KSHZ-ja organizoi trajnim obligativ për KKZ-të dhe KZ-të, edhe pse u mbajt me vonë se sa termini i caktuar. Vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it të cilët morën pjesë në seancat trajnuese raportuan se në shumë raste, trajnimi nuk ishte efektiv dhe nuk arriti të mbajë vëmendjen e shumë pjesëmarrësve. Me qëllim që t'u drejtohet mangësive në realizimin e punës së disa KZ-ve dhe KKZ-ve gjatë rrethit të parë, KSHZ-ja miratoi rekomandime më praktike për punën e KKZ-ve dhe KZ-ve gjatë rrethit të dytë, si dhe mbajti trajnime shtesë.

Mangësitë në lidhje me udhëzimet dhe trajnimin e KKZ-ve dhe KZ-ve ishin ndoshta më të dukshme në vështirësitë që disa nga ato i hasën më mbushjen e saktë të formularëve të rezultateve. MVZ i OSBE/ODIHR-it i prezantoi KSHZ-së disa kopje të formularëve nga KKZ-të dhe KZ-të që kishin jopërputhshmëri me numrat e publikuara në uebfaqen e KSHZ-së. Më drastike ishte rasti në Komunën e Ohrit, ku formulari me rezultate i KKZ-së nga rrethi i parë i zgjedhjeve për këshill komunal i cili i ishte dhënë MVZ të OSBE/ODIHR-it (formulari 21-D) përmbante numrin 11 492 për fletëvotime të pavlefshme, kurse në uebfaqen e KSHZ-se ky numër ishte 1 476 (numri i dhënë në uebfaqen e KSHZ-së përputhej me numrat tjerë nga ajo komunë).

Problemi me trajnimin e pamjaftueshëm doli si rrjedhojë e asaj se zyrtarët e KZ-ve ishin të rinj dhe si rezultat i procesit të rastësishëm të seleksionimit të anëtarëve.

KSHZ-ja filloi programin e kufizuar për edukim të votuesve vetëm 10 ditë para rrethit të parë të zgjedhjeve. Këtu u përfshinë tre spote televizive dhe tre në radio të cilët patën për qëllim të motivojnë votuesit të marrin pjesë, t'u shpjegohet procesi i votimit dhe të paralajmërohen

⁷

Shih referencën në fusnotën 5.

⁸

Neni 60 (1) i Kodit zgjedhor i definon parashtuesit e listave si "parti politike të regjistruara individualisht, në koalicion si dhe grup votuesish".

kundër dhunës zgjedhore. Për rrethin e dytë, KSHZ-ja e përsëriti programin e njëjtë për edukim të votuesve

C. ADMINISTRIMI I RRETHIT TË DYTË

Gjatë periudhës midis dy rretheve zgjedhore, KSHZ-ja nuk funksioni aq paanshëm sa para rrethit të parë, dhe fryma e kolegialitetit dhe konsensusi u zëvendësua deri në një shkallë me intereset partiake. Kishte poashtu ndryshueshmëri në vendimet e KSHZ-së në lidhje me atë nëse duhet ose jo të kontrollohet materiali zgjedhor kur të shqyrtohen ankesat zyrtare (për hollësi shih Pjesën XVI, Ankesat dhe Ankimimet në ditën e zgjedhjeve).

Disa herë, punës së KSHZ-së i mungonte transparencë. Për shembull, KSHZ-ja zyrtarisht vendosi vonë mbi dizajnin dhe pamjen e fletëvotimeve për rrethin e dytë, më 30 mars. Mirëpo, vëzhguesit afat-gjatë të MVZ e OSBE/ODIHR-it raportuan se këto fletëvotime ishin shtypur më 28 mars. KSHZ-ja nuk i miratoi procesverbalet e 26 seancave që i mbajti pas vendosjes së MVZ të OSBE/ODIHR-it, edhe përpos kriterit nga Neni 29 nga Rregullorja e brenshme e KSHZ-së që thotë se në çdo seancë bëhet miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme.

KSHZ-ja angazhoi personel nga Qeveria (Ministria e drejtësisë) në punën e saj për pranimin e materialit zgjedhor nga KKZ-të pas dy rretheve të votimit, si dhe gjatë shqyrtimit të ankesave të parashtruara në KSHZ dhe marrjen e vendimeve mbi to. Edhe pse kjo i nevojiteshte KSHZ-së përshkak të mungesës së personelit adekuat, praktika e përmendur më parë kishte potencial të prishë pavarësinë e KSHZ-së në procesimin e ankesave.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Deri më 1 shtator 2009, kur KSHZ-ja do të marrë përgjegjësi, Ministria e drejtësisë ka kompetencë për mirëmbajtjen dhe përditësimin e listës së votuesve. Për zgjedhjet e vitit 2009, listat e votuesve ishin në dispozicion për kontroll publik prej më 20 janar deri më 3 shkurt 2009. Gjithsej 195 323 qytetarë i kontrolluan të dhënat e veta dhe u bënë gjithsej 1 525 ndryshime. Listat e votuesve u mbyllën më 18 shkurt, me gjithsej 1 792 082 votues të regjistruar, prej një popullate e vlerësuar në 2, 04 milion njerëz⁹. Këto numra lindën shqetësim të madh publik për atë se listat e votuesve ishin zmadhuar, meqë numrat në lista paraqisnin segment të paarsyeshëm në proporcion me popullatën.

Dyshime mbi vërtetësinë e listave votuese hodhi numri i madh i qytetarëve që jetojnë jasht emrat e të cilëve janë në listat votuese dhe kishte potencial që kolona e tyre në listat votuese të manipulohet. Rreth 73 000 qytetar të të regjistruar që jetojnë jashtë u futën në listat votuese dhe u shënuan me asteriks (*). Mirëpo, shumë bashkëbisedues i treguan MVZ të OSBE/ODIHR-it që ato besojnë se numri real i qytetarëve që jetojnë jashtë është disa herë më i lartë. Rekomandimet e shumëpërsëritura të OSBE/ ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut për revidim të listave të votuesve, mbetet të shqyrtohen në të ardhmen.

Shqyrtim i mëtejshëm në lidhje me listat votuese duhet t'i jepet edhe faktit se pragu për zgjedhjet presidenciale dhe komunale bazohet në daljen në zgjedhje nga numri i votuesve të regjistruar, për dallim të pragjeve më të zakonshme ku merret numri i votuesve që kanë dalë

⁹ Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe vlerësime të tjera mund të gjenden në:
www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18

në zgjedhje. Një listë e zmadhuar rrit rrezikun për zgjedhje të pavlefshme si në rastin me zgjedhjet presidenciale (shih Pjesën IV në lidhje me Sistemin zgjedhor).

U përgatitën dy mostra identike të listave të votuesve për çdo vendvotim, një për zgjedhjet presidenciale dhe një për zgjedhjet lokale.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Shtatë kandidatura për kryetarë u dorëzuan dhe u konfirmuan në KSHZ: Imer Selmani (Demokracia e re), Mirushe Hoxha (Partia demokratike shqiptare, PDSH), Nano Ruzhin (Partia Demokratike Liberale), Gjorge Ivanov (VMRO–DPMNE), Ljube Boshkoski (i vetë-nominuar), Agron Buxhaku (BDI) dhe Ljubomir Frçkoski (LSDM). Gjashtë nga këto kandidatë u mbështetën nga parti politike, kurse vetëm dy prej tyre janë antarë aktiv të partive nominuese. Asnjë kandidati nuk iu refuzua regjistrimi.

Për zgjedhjet lokale, KKZ-të dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit morën gjithsej 374 kandidatura për kryetarë të komunave dhe 703 lista të kandidatëve për këshilltarë komunal; nga këto, 364 dhe 702 u konfirmuan, respektivisht. Gjithsej, 13 709 kandidatë garuan për 1391 poste për këshilltarë në 84 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Kandidatët potencial për president duhet të prezantojnë nënshkrime mbështetëse nga 10 000 votues të regjistruar ose 30 anëtarë të Parlamentit. Disa kandidatë potencial ranë nga gara pasi nuk mundën të mbledhin numrin e duhur të nënshkrimeve. Në zgjedhjet lokale, kandidatët e pavarur dhe listat e dorëzuara nga grupe votuesish duhet gjithashtu të dorzojnë nënshkrime mbështetëse, numri i të cilave ndryshon sipas numrit të popullatës në komunën në fjalë.

Procesi i mbledhjes së nënshkrimeve për mbështetje të listave të kandidatëve¹⁰ është shumë restriktiv dhe i vështirë, meqë qytetarët mund të nënshkruhen vetëm për një listë për çdo garë dhe këtë duhet ta bëjnë në zyrën lokale ose rajonale të Ministrisë së drejtësisë. Disa kandidatë ose kandidatë potencial pohuan tek MVZ i OSBE/ODIHR-it që ky sistem i vuri në pozitë të palakmueshme kandidatët e opozitës, pjesërisht për shkak se shumë qytetarë thuheshte që ishin frikësuar të vizitojnë zyrat qeveritare dhe të regjistrojnë mbështetjen e tyre për kandidatët e opozitës. Në praktikë, sidoqoftë, sistemi nuk e parandaloi regjistrimin e madh dhe të shumëllojshëm të kandidatëve presidencial dhe komunal.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zyrtare 19 ditore filloi më 2 mars për rrethin e parë dhe u zhvillua deri në mesnatë më 20 mars. Mungesa e dispozitave të qarta se prej cka përbëhet fushata krijoi konfuzion se cili lloj i aktivitetit politik ishte i lejueshëm përpara se të fillonte fushata zyrtare. MVZ e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi një numër rastesh të zhvillimit të fushatës para 2 marsit, përfshirë këtu edhe prezantimin e sloganeve të disa kandidatëve presidencial, mbajtja e konventave partiake në mënyrë shumë publike dhe shfaqja e disa afisheve. Mirëpo, bashkëbiseduesit në përgjithësi nuk e morën këtë ceshtje si shqetsuese ose si temë ankese. KSHZ-ja dhe KR rishikuan mundësinë për të reaguar në lidhje me konventat partiake dhe mbulimin medial që patën, por vendosën që të mos veprojnë, pjesërisht sepse nuk morën asnjë ankesë.

¹⁰ Në bazë të Kodit zgjedhor (Neni 57 (1)), listë e kandidatëve parashtrohet për këshille komunale dhe listë e kandidatit parashtrohet për zgjedhjet presidenciale dhe lokale.

Pas fillimit të periudhës së fushatës zyrtare më 2 mars, partitë politike dhe kandidatët presidencial u angazhuan në program të zëshëm të tubimeve. MVZ e OSBE/ODIHR vëzhgoi rreth 100 tubime para rrethit të parë, në të cilët liderët partiak, kandidatët presidencial dhe kandidatët për kryetarë komune, si dhe kandidatët për këshilltarë komunal shpesh paraqiteshin së bashku. Disa raste ku pati ____clash të orareve të tubimeve u zgjodhën në mënyrë të qetë. Tubimet kaluan pa asnjë ndërprerje dhe përgjithësisht kishin pjesëmarrje të mirë. Fushata ishte shumë e dukshme mbarë vendit, përfshirë edhe përdorimin e tepërt të billbordeve komerciale dhe afisheve. Disa komuna u vonuan me caktimin e lokacioneve në të cilat kandidatët mund të vendosnin afishe (kriter i Kodit zgjedhor), dhe disa caktuan vende të joadekuate. Edhe pse disa afishe u shqyen ose shpërfytyruan, ky nuk u tregua si problem serioz.

Aktivitetet e fushatës për rrethin e dytë ishin në përgjithësi më e heshtur, me më pak ngjarje publike. Partitë politike dhe kandidatët për kryetarë të komunave u koncentruan në aktivitete të heshtura si për shembull fushatë derë-më-derë, ose tubime të vogla nëpër lagje. Partia qeveritare, VMRO-DPMNE, përjashtoj nga ky trend, meqë zyrtarë të lartë dhe kabinetet e Ministrave vizituan pjesë të ndryshme të vendit për të mbështetur kandidatët partiak për kryetarë të komunave, dhe billborde të ri të VMRO-DPMNE-së u vendosën në kryeqytet, duke paraqitur Kryeministrin me kandidatët për kryetarë të komunave.

Në nivel nacional, fushatën e dominuan çështjet për anëtarësim në BE dhe NATO si dhe skenare për zgjidhje të çështjes së emrit me Greqinë. Përkundër nivelit të lartë të aktiviteteve të kandidatëve presidencial para rrethit të parë, fokusi i interesit publik u përqëndrua më shumë në çështje lokale se sa nacionale. Çështjet komunale vazhduan të dominojnë agjendën e fushatës dhe pothuajse e rritën prezencën e tyre gjatë rrethit të dytë.

Një proces zgjedhor i qetë dhe demokratik u konsiderua si kriter kyç për progresin e vendit drejt integritimit Evro-Atlantik, qëllim ky që u mbështet nga të gjithë partitë e mëdha politike dhe zuri vend të lartë në fushatën e tyre nacionale. Gjatë gjithë procesit zgjedhor, kandidatët dhe partitë e përsërisnin përkushtimin e tyre që të mbajnë zgjedhje demokratike dhe u betuan që do t'i largohen çdo tipi të incidenteve të dhunshme që ndikuan negativisht gjatë zgjedhjeve të 2008-ës. U nënshkruan Kode nacionale dhe lokale për mbarëvajtje që u sponsoruan nga Instituti nacional demokratik (IND), që u shoqërua me fushatë të madhe për zgjedhje demokratike. Mirëpo, një proces i mirë demokratik shpesh duket se barazohet me ambient ku s'ka dhunë, me pak fokusim në elementet tjera që janë themelore për demokracinë.

Gjatë gjithë kohës që ishte në ish republikën Jugosllave të Maqedonisë MVZ i OSBE/ODIHR-it mori një numër të madh të informatave shqetësuese të pavërtetuara nga mbarë vendi për presion ose frikësim të qytetarëve në lidhje me zgjedhjet. MVZ i OSBE/ODIHR-it u ra pas këtyre raportimeve dhe doli që shumica ishin të besueshme. Edhe atëherë kur informatat nuk mund të vërtetoheshin, shpesh shihej qartë që njerëzit u besonin atyre, duke nënvlerësuar kështu “të drejtën e tyre të japin votën e vet pa frikë për hakmarrje”¹¹. Ky problem seriozisht e dëmtoi kualitetin e procesit zgjedhor.

Informatat më të shpeshta kishin të bëjnë me kërcënime se nëpunësit e sektorit publik do t'i humbin vendet e tyre të punës nëse nuk mbështetnin ndonjë kandidat. Nëpunësit e sektorit publik u tregua që ishin të pambrojtur ndaj këtyre kërcënimeve duke marrë parasysh politizimin e shërbimeve civile. Thuhej që u ishte kërkuar një numëri të madh të nëpunëve

¹¹ Paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së

shtetëror të dorëzojnë lista të njerëzve të tjerë që do ta mbështesin partinë qeveritare. Përveç kësaj, pati raportime të frikësimit të mbështetësve potencial të kandidatëve të opozitës, dhe kërcënime se do t'u shkëputen pensionet dhe përfitimet sociale, nëse shfrytëzuesit e tyre nuk do të votonin partinë që ka kontrollin në nivel lokal ose nacional. Pjesa dërmuese e këtyre pohimeve kishin të bëjnë me veprime të zyrtarëve shtetëror dhe aktivistëve të partive qeveritare. Këshilli për radiodifuzion e informoi MVZ të OSBE/ODIHR-it që ishte nën presion të qeverisë për t'i ndryshuar vlerësimet, në të cilin rast refuzoi. Një numër shumë i madh i kandidatve, zyrtarve të lartë qeveritar dhe OJQ-të i vërtetuan MVZ të OSBE/ODIHR-it besimin e tyre që frikësimi i votuesve paraqiste në të vërtetë problem serioz.

Gjatë ditëve të fundit të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve më 22 mars, Kryeministri doli me deklarata publike, dhe i informoi zyrtarët publik që kesi lloj veprimesh nuk do të tolerohen. Sidoqoftë, përgjigjja e vonuar e Qeverisë ishte e pamjaftueshme për të krijuar klimë pa frikësime dhe frikë nga hakmarrja. Para rrethit të dytë të zgjedhjeve, raportet për frikësim të votuesve u rritën në intensitet, posaçërisht në lidhje me garat e ngushta për kryetar komune në shumë pjesë të vendit. Edhe pse Kryeministri përsëri foli publikisht kundër presionit dhe frikësimit, përpjekjet e tij nuk mjaftonin që kjo të ndalej dhe të kthehej besimi tek popullata.

Përgjithësisht, garuesit në zgjedhje bënë përpjekje të mëdha që të përdorin fjalor të matur gjatë fushatës së tyre; mirëpo, tensionet ishin të larta në disa komuna me rezultate të ngushta midis garuesve, posaçërisht midis dy rretheve. Për shembull në Strugë, Ohër, Demir Hisar, Makedonski Brod, Gostivarë, Berovë, Petrovec dhe Shuto Orizarë. Pati incidente gjatë periudhës mes dy rretheve – duke përfshirë përlëshjet e demonstruesve në sheshin qendror të Shkupit mbi planet për ndërtimin e një kisha, dhe përlëshjet e nxënësve nga grupet e ndryshme të etniteteve në një shkollë në Strugë – që zunë vend të rëndësishëm në media dhe kjo u kthye në çështje konfrontimi midis kandidatve dhe partive në nivel nacional. Pas rrethit të dytë të zgjedhjeve, tensionet mbetën të larta në Strugë dhe Shuto Orizarë, ku rezultatet nga zgjedhjet për kryetar komune nuk u pranuan me gatishmëri nga partitë që humbën. Qindra banorë të Shuto Orizarës, komunë e banuar kryesisht me romë etnik, marshuan deri te ndërtesa e Parlamentit më 8 prill në shenjë proteste kundër rezultateve.

Kandidatët presidencial dhe lokal garuan kryesisht në bashkësitë e tyre etnike, dhe kishte disa raste gjatë fushatës kur u përdor fjalor nacionalist dhe përçarës në bazë etnike. I vetmi kandidat që bëri përpjekje të mëdha të zhvillojë fushatë tej vijave etnike ishte Imer Selmani (Demokracia e re).

Modeli i votimit në baza etnike u bë posaçërisht i dukshëm gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, kur mbetën në garë vetëm kandidatë maqedonas etnik. Kishte një numër jo të zakonshëm të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme (6, 2% nga votat e dhëna) gjatë rrethit të dytë, posaçërisht në vendbanimet e banuara me shqiptarë etnik. Gjithashtu u shënuar pjesëmarrje e ulët në mesin e shqiptarëve etnik gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, edhe përkundër faktit se partia qeveritare e maqedonasve etnik, VMRO-DPMNE, dhe partneri i saj i koalicionit, partia shqiptare BDI, arritën marrëveshje për mbështetje të dyanshme për kandidatët e tyre në nivel lokal dhe nacional gjatë rrethit të dytë. Shembuj për dalje shumë të ulët të votuesve në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale përfshijnë Zhelinën, me 1, 6% krahasuar me 35, 2% për rrethin e dytë të votimeve për kryetar komune që u mbajt në të njëjtën kohë, dhe 2, 51% në Likovë krahasuar me 40, 2% për garën për kryetar komune në rrethin e dytë.

U mbajtën disa takime të liderëve të partive politike kryesore gjatë periudhës para-zgjedhore,

të organizuara nga Kryeministri, me qëllim të promovimit të qasjes paqësore dhe bashkëpunuese gjatë zgjedhjeve. Këto mbledhje duket se kontribuan për një atmosferë përgjithësisht të qetë para dhe gjatë dy ditëve të zgjedhjeve. Në përpjekje për të promovuar atmosferë qytetare të fushatës, kandidatët presidencial para rrethit të parë morën iniciativa t'i sjellin kundërshtarët e tyre në takime të përbashkëta.

Përpjekjet për të siguruar atmosferë për zgjedhje të qeta dhe pa dhunë përgjithësisht ishin të suksesshme. Ministria e punëve të brendshme regjistroi gjithsej 77 raste të dhunshme gjatë dy rrethëve të procesit zgjedhor, dhe asnjëri prej tyre nuk ishte i tipit serioz¹². Minsitria e punëve të brendshme ngriti gjithsej 11 aktpadi për kudërvajtje kundër individve dhe inicoi tri aktpadi penale për “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit”, “keqpërdorim i të drejtës për votim”, dhe “rishfet gjatë votimit”.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ OSBE/ODIHR-së theksuan se roli i drejtë i policisë dhe organeve tjera për zbatim të ligjit, në parandalimin e dhunës në lidhje me zgjedhjet, do të jetë kyç për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Në muajin shkurt, Ministria e punëve të brendshme prezantoi principet e një plani¹³ gjithpërfshirës për zgjedhjet, i cili u ndërtua direkt nga përvojat e zgjedhjeve të vitit 2008. Në bazë të këtyre principeve, tetë zyrat rajonale të policisë, në koordinim me komandirët e stacioneve lokale të policisë, elaboruan plane të cilët më pastaj u përfshijnë në një plan gjithpërfshirës për stacionimin e policisë, që u mbështet nga një program trajnues mbi rolin e policisë gjatë zgjedhjeve.

Roli konstruktiv i policisë në sigurimin e atmosferës së qetë dhe padhunshme gjatë rrethit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve u vërejt nga shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it, dhe prezenca e policisë gjatë dy ditëve të zgjedhjeve u karakterizua nga vëzhguesit ndërkombëtar si e dukshme dhe siguroese, por jo e tepruar. Sidoqoft, MVZ e OSBE/ODIHR-it gjithashtu mori informata të besueshme që policia ka marrë rol aktiv gjatë fushatës duke mbështetur partinë qeveritare në disa raste, si për shembull në Shtip, Delçevë, Demir Hisar dhe Makedonski Brod.

Që kur u shpallën zgjedhjet, Komisioni shtetërorë për parandalim të korrupsionit në mënyrë aktive i përkujtonte organet shtetërore dhe lokale që të përmbahen nga shpallja e investimeve të reja, nënshkrimin e kontratave, punësimin e personelit, shfrytëzimin e fondeve për projekte të reja ose bërjen e pagesave të mëdha gjatë periudhës së zgjedhjeve, sic thuhet në Ligjin për parandalim të korrupsionit. Komisioni njohtoi zyrën e prokurorit publik mbi dy raste ku thuhej se ishin blerë vota dhe vepruan që të shqyrtojnë ankesën e dorëzuar nga Partia e re socialdemokrate (PRSD) e cila pohonte keqpërdorim të resurseve nga ana e Qeverisë.

¹² Incidentet që iu raportuan MVZ të OSBE/ODIHR-së përfshinë persona të panjohur që kishin thyer zyrat e partive politike në komunën e Shkupit, në Cair; dëmtimi i flamujve partiak në Makedonska Kamenica; përlshje midis aktivistëve të BDI-së dhe PDSH-së në Tetovë; zënkë në mes aktivistëve të kandidatit presidencial Ljube Boshkoski dhe mbështetësit e VMRO-DPMNE-së; dëmtim më i vogël i dy zyrave të BDI-së në rrethin e Gostivarit; kërcnime të aktivistëve të Demokracisë së re në Gostivar; dhe një tjetër përlshje midis anëtarëve të dy partive politike rrome.

¹³ Planit pati për qëllim zbatimin e masave preventive, me prezencë më të madhe të policisë në vendbanimet ku ishin vërejtur probleme lidhur me zgjedhjet në të kaluarën. E gjithë policia – përfshirë edhe atë të pauniformuar – dhe veturat e policisë duhej të shënohen për ditën e zgjedhjeve. Njësitit Alfa, forcat speciale të specializuara për luftë kundër krimit të organizuar, të cilat kishin qenë aktive në shumë vendbanime shqiptare gjatë parregullësive zgjedhore të vitit 2008, u restriktua në rajonin e Shkupit, me një ekip në Kumanovë, në rast se duhet t'u përgjigjet aktiviteteve kriminele. Planit poashtu mbuloi sigurimin dhe shoqërimin e fletëvotimeve dhe materialit tjetër zgjedhor, si dhe sigurimin e vendvotimeve, dhe hapsirave të KKZ-ve dhe KSHZ-së.

Përpara se të shpallehin zgjedhjet, Qeveria u angazhua në fushata të shtrenjta dhe me publikitet shumë të lartë që mbështetnin politikën dhe programet e saj. Edhe pse kjo u ndërpre kur u shpallën zgjedhjet, sic kërkohet me Nenin 84-a të Kodit zgjedhor, partitë e opozitës dhe përfaqësuesit e mediave theksuan që fushatat publike ishin aq të përhapura të pranishme që kishin efekt të vazhdueshëm në fushatën zgjedhore dhe kishin bërë që shumica e mediave të varen nga të ardhurat e reklamave qeveritare.

Procesimi i rasteve gjyqësore kundër personave të paditur me aktpadi në lidhje me zgjedhjet e 2008-ës vazhduan gjatë periudhës së zgjedhjeve të 2009-ës. Që nga 31 maji, OSBE-ja u informua se gjithsej 26 individë janë paditur në lidhje me zgjedhjet e vitit 2008. Kjo ishte vetëm një pjesë e vogël e mbi 200 personave që u paditën në fillim. Disa bashkëbisedues, përfshirë edhe liderët e dy partive në opozitë, i thanë MVZ të OSBE/ODIHR-it që ato besonin se rastet shqyrtoheshin ndryshe, varësisht nga përkatësia partiake e të akuzuarit; Qeveria e mohoi këtë pohim. Bashkëbiseduesit, përfshirë edhe prokurorë, gjithashtu theksuan se një nga pengesat më të mëdha në procesimin e disa rasteve ishte ajo se dëshmitarët patën frikë të dëshmojnë ose ta mbështesin dëshminë e më hershme.

A. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës është i rregulluar me rregullativa më të përsosura në Kodin zgjedhor të ndryshuar. Në bazë të legjislacionit, organizuesit e fushatës duhet të hapin llogari të veçantë bankare për zgjedhjet, dhe të gjitha harxhimet për fushatën duhet të mbulojnë nga fondet e deponuara në këtë llogari. Dispozitat e reja e zgjerojnë definicionin për donacionet, që tani përfshin sigurim të shërbimeve për organizatorët e fushatës zgjedhore pa pagesë ose me zbritje. Personave fizik të autorizuar u lejohet të donojnë shumë prej 5 000 euro, përderisa personave juridik të donojnë shumë prej 20 000 euro.

Sidoqoftë, këto limite nuk zbatohen për disa donacione në të mira materiale dhe shërbime, për të cilat Neni 83.3 i Kodit zgjedhor cakton përjashtime; këtu përfshihen të siguruarit të mira materiale dhe shërbime me çmim të zbritur, që është veçanërisht me rëndësi për zbritje nga mediat emituese dhe ato të shtypit për reklamim politik. Këto përjashtime, në mënyrë shumë efektive u ikin limiteve për donacione të fushatës dhe lejojnë donacione të pakufizuara nga biznese dhe medime. Në fushatë për një listë zgjedhore nuk mund të shpenzohet më shumë se 180 denarë (rreth 3 euro) për një votues të regjistruar në një njësi zgjedhore.

Në fund të periudhës së fushatës, organizatorët duhet të dorëzojnë raport financiar tek KSHZ-ja, Agjencioni shtetërorë për revizion, Komisioni shtetërorë për parandalim të korrupsionit, Këshillat komunal dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit. Mirëpo, formulari për raportim është i dhënë nga Ministria e financave dhe është i njëjti që përdoret për regjistrimin e donacioneve; aty përfshihet vetëm lista e donacioneve dhe donorve, por jo edhe shpenzimet. Përveç kësaj, Agjencioni shtetërorë për revizion i shpjegoi MVZ-së të OSBE/ODIHR-it që ato nuk bëjnë revizion të të gjithë kandidatëve dhe partive automatikisht pas zgjedhjeve, por vetëm fokusohen në partitë e mëdha dhe kandidatët e finansuar nga buxheti i shtetit. Kjo i nënvleron rregullat e finansimit dhe efikasitetin e rregullativave për finansim të fushatës. Nuk kishte plane, për shembull, për të bërë revizion të financave të fushatave të asnjërit nga kandidatët presidencial.

Mundësinë për kthimin e shpenzimeve të fushatës e kanë vetëm kandidatët e zgjedhur dhe atë 15 denarë për një votë të marrë. Shuma e kthyer paguhet nga buxheti shtetërorë ose lokal, në bazë të vendimit nga Parlamenti, Këshilli i komunës ose Këshilli i Qytetit të Shkupit. Mirëpo, këto institucione mund të vendosin të mos ua kthejnë shpenzimet kandidatëve, nëse

Agjencioni shtetërorë për revizion gjen parregullësi në raportin e tyre financiar. Rregullat që aplikohen dhe procedurat që duhet të merren nëse gjenden parregullësi nuk janë qartë të caktuara në Kodin zgjedhor, dhe asnjëri nga institucionet me të cilat u takua MVZ i OSBE/ODIHR-it nuk diti të japë përgjigje të qartë për atë se cili është organi adekuat të inicojë procedura të tilla.

IX. MEDIAT

A. HISTORIATI

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një ambient të shumëllojshëm mediatik që përbëhet nga rreth 150 stacione televizive dhe radio stacione, dhe një numër të madh të mediave të shkruara, përfshirë këtu edhe dhjetë gazeta të përditshme. Televizioni është mediumi kyç dhe burimi më kryesor për informim, transmetuar kryesisht nga pesë TV stacione kombëtare private dhe një transmetues publik.

Transmetuesi publik, Radio televizioni i Maqedonisë (RTVM), përbëhet nga tre stacione me mbulim mbarë territorit të vendit (plus një kanal satelitor), dhe tre radio stacione nacionale. TVM është shumë i varur nga subvencionet shtetërore, kryesisht për shkak të vështirësive për mbledhjen e taksave parapaguese nga shumica e qytetarëve. Deficiti financiar i kamotshëm dhe varësia nga subvencionet e rrezikojnë pavarësinë e transmetuesit publik.

Kanalet televizive kombëtare private dominojnë në tregun reklamues, në të cilin një numër i madh i mediave garojnë për të ardhura të kufizuara. Fushatat e gjëra reklamuese qeveritare në favor të politikave të saj, e kanë bërë atë reklamuesin më të madh e të vetëm në vend; kjo u përmend nga shumë bashkëbisedues si një kërcënim potencial për pavarësinë e mediave. Këto fushata nuk u transmetuan gjatë periudhës së zgjedhjeve, meqenëse emitimi i çdo lloj reklame të paguar nga shteti ose nga buxhetet e komunave ishte i ndaluar me rregulloret gjatë zgjedhjeve.

Trupi rregullator për mediat elektronike është Këshilli për radiodifuzion (KR), një bord nëntë anëtarësh i emëruar nga Parlamenti. KR-ja pati vetëm gjashtë anëtarë gjatë periudhës së zgjedhjeve, sepse Parlamenti nuk arriti të emërojë tre anëtarë me kohë. Ndonëse kjo gjë i cungoi aftësitë e KR-së, ai funksionoi në mënyrë të paanëshme dhe profesionale.

B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT

Kodi zgjedhor dhe Ligji për veprimtari radiodifuzive formojnë kornizën themelore ligjore që administron mbulimin e zgjedhjeve dhe të fushatës në media. Siç është përcaktuar me Kodin zgjedhor, KR-ja më 16 janar miratoi *Rregulloren për qasje të barabartë te prezantimi në media gjatë fushatës zgjedhore* të rregullojë hollësitë e mbulimit të zgjedhjeve në media. Përderisa gjatë zgjedhjeve të kaluara, Parlamenti mbante përgjegjësi për miratimin e rregulloreve të tilla, KR-ja në mënyrë direkte e mori përsipër miratimin e *Rregullores* për këto zgjedhje. Kjo u tregua si mekanizëm më efikas, si për shembull, para zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2008, Parlamenti nuk miratoi rregullore për mediat para shpërbërjes së tij.

Rregullorja e Këshilli për radiodifuzion parashihte që emituesit të cilët mbulonin zgjedhjet duhet ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, balancuar dhe të paanshmë dhe duhet t'u mundësojnë garuesvë mundësi të barabarta qasjeje në programet e tyre. Kjo Rregullore gjithashtu rregulloi prezantimin e kandidatëve në programe informative, duke kërkuar që mediat të mundësojnë

prezantimin e kandidatëve presidencialë mbi baza të barazisë gjatë programeve të tilla. Prezantimi i kandidatëve në mediat kombëtare në zgjedhjet lokale kërkohej të jetë proporcional, mbi bazat e numrit të përgjithshëm të kandidatëve dhe listave për këshilltarë të dorëzuara nga secila parti. Mbulimi mediatic i aktiviteteve të Qeverisë nuk kishte të drejtë të favorizojë fushatën e ndonjërit nga kandidatët. Mediat publike kishin për detyrë të informojnë publikun mbi procesin zgjedhor dhe aktivitetet e garuesve. *Rregullorja* nuk e rregulloi në veçanti çështjen e ndarjes së prezantimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale nga mediat lokale dhe rajonale, si dhe nuk rregulloi çështjen e ndarjes së kohës për mbulimin në programe informative midis kandidatëve në rrethin e dytë. Këshilli për radiodifuzion i tha MVZ të OSBE/ODIHR-it se mediat duhet të respektojnë parimin e barazisë në të dyja rastet.

Neni 74 (2) i Kodit zgjedhor i jep KR-së mandatin për të mbikëqyrur mbulimin mediatic të zgjedhjeve, jo vetëm gjatë fushatës zyrtare zgjedhore, por edhe nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fund të votimit në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, kompetencat e KR-së për të kontrolluar mediat gjatë periudhës para fushatës nuk janë të qarta. Më 16 janar, KR-ja lëshoi udhëzimet për periudhën e para fushatës, me të cilat mediave u ndalohej të transmetojnë aktivitete të lidhura me zgjedhjet vetëm gjatë programeve të lajmeve. Emisionet tjera të lidhura me zgjedhjet, përfshi edhe intervistat me liderë politikë, ose me kandidatë potencialë apo të regjistruar nuk u lejuan. Udhëzimet e KR-së kishin për qëllim të parandalonin prezantimin e pabarabartë të kandidatëve në periudhën e para-fushatës që kanë qenë problem në të kaluarën.

Pati një debat të gjerë mbi këto udhëzime në komunitetin mediatic, ndërkohë që disa media kombëtare pretendonin se në mënyrë të padrejtë u ishte kufizuar sasia e informacioneve që mund t'u ofrohej votuesve. Nga ana tjetër, disa media lokale i mirëpritën udhëzimet si mburojë ndaj presioneve të partive politike, të cilat kërkonin mbulim mediatic para fillimit të fushatës. KR-ja i implementoi dispozitat në mënyrë efikase dhe të paanshme. Ai e monitoroi situatën dhe e lëshoi paralajmërime, si dhe dorëzoi aktpadi kundër disa emituesve, të cilët transmetuan materiale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Pas kësaj, mediat në përgjithësi iu përmbajtën udhëzimeve. Megjithatë, gjykatat ende nuk kishin sjellë vendime përfundimtare për këto raste të para-fushatës as pas përfundimit të zgjedhjeve. Veprimi i ngadalshëm i gjykatave theksoi dobësinë e sistemit: do të pengonte aplikimin e rregullave me kohë nga KR-ja, si dhe me gjasë la disa media pa mundësi për t'u korrigjuar me kohë në rast se gjykata vendoste në favor të tyre.

Kodi zgjedhor e kufizon kohëzgjatjen e reklamave të paguara politike, ku mediave u lejohej të emitojnë 15 minuta në orë. Ligji për veprimtari radiodifuzive lejon më së shumti 12 minuta. Mediave publike nuk u lejohej të ofrojnë reklama të paguara politike.

C. MBIKQYRJA E MEDIAVE NGA MVZ I OSBE/ODIHR-IT

Që nga 16 shkurti, MVZ i OSBE/ODIHR-it ndërmori një analizë kuantitative dhe kualitative të transmetuesve më të mëdhenj të dy kanaleve televizive publike, TVM 1 dhe TVM 2 dhe të katër kanaleve televizive kombëtare private – A1, Alsat-M, Kanal 5 dhe Sitel – si dhe të programit të mbrëmjes të lajmeve në TV Alfa. Gjithashtu u mbikëqyrën pesë gazeta të përditshme, *Dnevnik*, *Koha*, *Lajm*, *Nova Makedonija* dhe *Vreme*. Përveç kësaj, MVZ i OSBE/ODIHR-it ndërmori mbikëqyrje të kufizuar të më shumë kanaleve televizive lokale dhe rajonale për ta vlerësuar mbulimin e tyre të fushatës.

Gjatë dy javëve që i paraprinë fillimit të periudhës së fushatës zyrtare (16 shkurt – 1 mars) të gjitha mediat transmetuese që u mbikëqyrën e siguruan Qeverinë me pjesën më të madhe të

materialit të lajmeve, dhe së paku një e treat e kësaj kohe u përkushtua aktorëve politik. Në numrin më të madh të mediave, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja morën vecanërisht më shumë mbulim të fushatës se sa partitë tjera politike; mbulim më të balancuar partive u dhanë televizioni A1 dhe ALsat-M. Televizioni publik TVM 2, i cili transmeton kryesisht në shqip, e fokuso i mbulimin e vet në partitë etnike shqiptare. Nuk ekziston kriter ligjor për ndarje të barabartë dhe të drejtë të kohës së transmetimit gjatë periudhës para fushatës, meqë korniza ligjore nuk e rregullon prezantimin mediatik të aktorëve politik jashtë periudhës së fushatës zyrtare.

Gjatë periudhës së fushatës zyrtare para rrethit të parë, mediat elektronike dhe të shtypura i siguruan votuesit me një shumëllojshmëri të pikëpamjeve politike dhe informatave, kryesisht gjatë prezantimit të fushatës në lajme. Shumë media kombëtare dhe lokale gjithashtu transmetuan profile ose intervista me kandidatët presidencial dhe ato për kryetar komune. Para rrethit të dytë të zgjedhjeve, prezantimi ishte i ndryshueshëm, por më pak i gjerë se para rrethit të parë, duke reflektuar nivelin e ulët të aktiviteteve të fushatës gjatë kësaj periudhe. Shumica e mediave të mbikëqyrrura bënë përpjekje t'u përmbahen rregullativave për transmetim. Debatet midis shtatë kandidatëve presidencial u transmetuan nga disa stacione televizive (TV Telma, TV Sitel dhe TV A1) dhe radio stacionet (Kanal 77 dhe TVM 1) që u dha mundësi votuesve të krahasojnë garuesit para ditës së zgjedhjeve, më 22 mars. Para dy rretheve zgjedhore, dy kandidatët e mbetur presidencial morën pjesë në një debat televiziv të organizuar nga TVM-1. Kandidati presidencial i VMRO-DPMNE-së i refuzoi ftesat për pjesëmarrje në debate tjera të planifikuara. Debatet midis kandidatëve për kryetarë të qytetit të Shkupit dhe komunave të tjera u transmetuan në stacionet lokale dhe kombëtare para dy rretheve të zgjedhjeve; megjithatë, disa përpjekje tjera nuk u realizuan kur kandidatët refuzuan të marrin pjesë.

Para rrethit të parë të votimit, transmetuesi publik TVM i siguroi çdo kandidati presidencial nga 70 minuta prezantim pa pagesë, dhe secili kandidat për kryetar komune pati mundësi të shfrytëzojë tre minuta prezantim pa pagesë. Përveç kësaj, transmetuesi publik emitoi program lidhur me zgjedhjet duke u fokusuar në kandidatët për Kryetar Të Qytetit të Shkupit. Kandidatët për kryetarë të komunave që garonin në komuna me shumicë të shqiptarëve etnik.

Të dy kanalet e TVM-së gjatë fushatës zyrtare shpesh transmetonin lajme në lidhje me projektet qeveritare dhe iniciativat që përshkruanin mbështetje të Qeverisë. Rreth një e treta e kohëzgjatjes së prezantimit të aktorëve politik dhe garuesve në zgjedhje, gjatë programeve të lajmeve të kanaleve televizive publike gjatë periudhës së fushatës para rrethit të parë, iu përkushtua Qeverisë. Gjatë periudhës së fushatës midis dy rretheve zgjedhore, TVM-1 i përkushtoi 26% të mbulimit relevant të fushatës së Qeverisë, 37% VMRO-DPMNE-së dhe 22% LSDM-së. TVM 2 përkushtoi 28% të mbulimit të fushatës së Qeverisë, 26% BDI-së, 12% LSDM-së dhe nga 11% VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së.

Para rrethit të parë të votimit, TVM-1 siguroi mbulim të gjerë të fushatës, por nuk arriti të sigurojë mbulim të barabartë për të gjithë shtatë kandidatët presidencial, ku kandidatët e BDI-së dhe PDSH-së u mbuluan dukshëm më pak se sa kandidatët tjerë. Ky ishte, deri diku, rezultat i niveleve të ndryshueshme të aktiviteteve gjatë fushatës të kandidatëve të ndryshëm. Prezantimi i kandidatëve presidencial në programet informative të RTMV-2 ishte më e balancuar, edhe pse e pabarabartë. RTMV-1, gjatë periudhës mes dy rretheve, u dha mbulim të barabartë dy kandidatëve të mbetur, me atë që kandidati i VMRO-DPMNE-së u portretizua me një ton më pozitiv. TVM-2 siguroi mbulim të kufizuar të dy kandidatëve presidencial gjatë periudhës mes dy rretheve.

Në mesin e kanaleve televizive kombëtare private, Alsat-M siguroi prezantimin më të gjerë të zgjedhjeve presidenciale dhe lokale para rrethit të parë. Ky transmetues, si edhe A1 dhe Kanal 5, siguruan pergjithsisht prezantim të balancuar të partive dhe kandidatëve, si në kuptim të kohës, ashtu edhe në ton. Televizioni Alfa siguroi mbulim të ndryshueshëm të zgjedhjeve lokale, duke u fokusuar në më shumë komuna në programin e vet informativ. Televizioni Alfa i prezantoi VMRO-DPMNE-në dhe LSDM-në si dhe kandidatët e tyre presidencial më gjerë se partitë e tjera. Televizioni Sitel e bëri të njëjtën gjë. Ai gjithashtu i dha shumë hapsirë Qeverisë dhe tregoi njëanshmëri në favor të partive qeveritare në tonin e prezantimit, me këtë e rriti përparësinë e atyre në qeveri.

Para rrethit të dytë të votimeve më 5 prill për Kryetar shteti, kryetarë të komunave dhe një numër të vogël të këshilltarëve komunal, të gjitha kanalet televizive private ia dhanë pjesën më të madhe të kohës VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, që kishin më shumë garues se partitë tjera. Megjithatë, tendenca për t'u fokusuar në këto dy parti rezultoi në prezantimin e kufizuar të garuesve të tjerë, veçanërisht BDI-së. Në përgjithësi, shpërndarja e programit informativ midis të gjitha partive dhe kandidatëve ishte më e balancuar në televizionin Alsat-M dhe A1, edhe pse ky i fundit tregoi njëanshmëri në favor të kandidatit për kryetar komune të PAE që garonte në Strugë. Nga të gjithë kanalet televizive private që u mbikqyrën, televizioni Alsat-M siguroi mbulimin më të gjerë dhe analitik të zgjedhjeve. Para rrethit të dytë, kandidati presidencial i LSDM-së u prezantua më shumë se sa oponenti i tij i VMRO-DPMNE-së në të gjithë kanalet televizive që u mbikqyrën, kryesisht për shkak të fushatës më pak të dukshme të kandidatit të VMRO-DPMNE-së.

Gazetat e mbikqyrura siguruan një shumëllojshmëri të pikpamjeve. Përgjithsisht, toni që u përdor në gazeta për aktorët politik ishte më kritik se sa ai në mediat elektronike. Para 22 marsit, *Dnevnik*, *Vreme* dhe *Nova Makedonija* e fokusuan prezantimin e tyre tek kandidatët presidencial që konsideroheshin favorit. Të përditshmet në gjuhën shqipe *Koha* dhe *Lajm* u dhanë më shumë hapsirë partive të shqipëtarve etnik, dhe përderisa portretimi i aktorve politik ishte i ndryshueshëm, të dy gazetat i dhanë kandidatit të Demokracisë së re pothuajse gjysmën e hapsirës së kandidatëve presidencialë, me portretizim përgjithsisht pozitiv. Gjatë periudhës midis dy rretheve, mbulimi i fushatës prej gazetave *Dnevnik*, *Vreme* dhe *Nova Makedonija* u fokusua kryesisht në partitë të cilat kishin më shumë kandidatë në balotazh - VMRO-DPMNE, LSDM dhe BDI. *Koha* dhe *Lajm* u dhanë më shumë hapsirë BDI-së dhe PDSH-së.

Vetëm disa garues përdorën më shumë reklama politike të paguara, me atë që fushata e VMRO-DPMNE-së ishte më dominuesja në të gjitha mediat e mbikqyrura. Gjatë periudhës midis dy rretheve, spotet e paguara të fushatës nëpër media ishin të rralla; VMRO-DPMNE përsëri përdori reklamim me pagesë më shumë se të gjithë garuesit.

KR-ja mbikqyri mbulimin e aktiviteteve në lidhje me zgjedhjet tek disa media transmetuese kombëtare dhe lokale gjatë dhe para fushatës. Rezultatet preliminare të kësaj mbikqyrjeje të mediave transmetuese kombëtare ishin përgjithsisht në të njëjtën linjë me vlerësimet e MVZ të OSBE/ODIHR-it.

X. PJESËMARRJA E FEMRAVE

Kishte vetëm një femër në mesin e shtatë kandidatëve presidencial, Mirushe Hoxha nga PDSH-ja, e cila nuk ia doli në rrethin e dytë. Kjo ishte, megjithatë, hera e parë që një femër kandidohet për Kryetar shteti, që shënoi një zhvillim pozitiv në politikën e vendit dhe thyerjen e disa barrierave gjinore të më hershme.

Në mesin e 364 kandidatëve për kryetarë të komunave, vetëm 13 ishin femra (3, 6%). Asnjëra nuk u zgjodh, dhe as që ndonjëra u kualifikua për rrethin e dytë të votimeve. Kjo paraqet një hap prapa sa i përket përfaqësimit gjinor në krahasim me zgjedhjet lokale të viteve 2000 dhe 2005 në të cilat u zgjodhën tri femra për kryetarë komune.

Neni 64.5 i Kodit Zgjedhor kërkon që në listat e kandidatëve “në secilin të tretin vend, së paku një vend do t’i rezervohet gjinisë më pak të përfaqësuar”. Kjo rezultoi në rritjen e përfaqësimit të femrave në nivel të këshillëve komunale, ku femrat numërojnë 27% të këshilltarëve të zgjedhur, krahasuar me 22% në vitin 2005. Megjithatë, disa bashkëbisedues raportuan informata për ushtrim të presionit tek disa femra të zgjedhura që të japin dorëheqje; në rast se ato japin dorëheqje, zëvendësohen me personin e radhës në listën e kandidatëve, i cili është zakonisht burrë.

Partitë politike dhe kandidatët në përgjithësi nuk bënë apele të veçanta për votueset femra ose nuk theksuan çështje në interes të femrave në programet e tyre. Më pak femra se meshkuj i ndoqën ngjarjet e fushatës. Në disa raste, posaçërisht në vendet e banuara kryesisht me shqipëtarë, aktivitetet e fushatës u ndoqën vetëm nga burra, përfshirë edhe disa aktivitete për Mirushe Hoxhën.

Nuk u tregua që gratë mbanin shumë pozita të nivelit të lartë, ose vendimmarrëse në partitë politike, edhe pse në Parlamentin aktual, 39 nga 120 deputetë janë femra dhe disa femra janë anëtare të Këshillit të Ministrave – 2 Ministre dhe dy zëvendës Ministre.

Neni 18 i Ligjit për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt kërkon që partitë politike të miratojnë, çdo dy vjet, “plan për mundësi të barabarta”, i cili përcakton metodat dhe masat që do t’i përdorin për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve në organet e partisë dhe listat e kandidatëve. Ndonëse nuk u tregua që ky kriter implementohet në praktikë.

Në bazë të Nenit 21.3 të Kodit zgjedhor, “secila gjini dihet të përfaqësohet në organet për menaxhim të zgjedhjeve me minimum 30%”. Ky kriter u respektua mirë në nivel të KKZ-ve dhe KZ-ve. Gjatë ditës së zgjedhjeve, më 22 mars, 44% e vendvotimeve të vizituara nga vëzhgues të MNVZ-së patën femër për Kryetarë të KZ-së, dhe 56% prej tyre patën femër si zëvendës kryetar. Në përgjithësi, partitë politike emëruan vetëm një femër për anëtare të KSHZ-së. Gjatë emërimit të anëtarve të propozuar të KSHZ-së, Parlamenti nuk e respektoi kriterin ligjor për përfaqsim gjinor në KSHZ.

Votimi familjar vazhdoi të paraqesë shqetsim serioz. Iniciativa të shumta nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare për ngritjen e vetëdijes publike dhe mbajtjen e trajnimeve që posaçërisht synonin parandalimin e votimit familjar nuk i dha rezultatet e dëshiruara. Gjatë rrethit të parë të votimit, MNVZ-ja vëzhgoi raste të votimit familjar në 19% të vendvotimeve të vizituara. Edhe pse pati variacione të dukshme rajonale (36% në komunat e banuara me shumicë shqiptare dhe 13% në pjesën tjetër të vendit), numrat në gjithë pjesët e vendit duhet të konsiderohen si të lartë. Më 30 mars, mes dy rrethëve zgjedhore, KSHZ-ja u dha KKZ-ve dhe KZ-ve udhëzime dhe paralajmërime me fjalor të ashpër për parandalimin e votimit familjar. Kjo qasje u tregua se ka efekt pozitiv, meqë rastet e votimit familjar të vëzhguara nga MVZ e OSBE/ODIHR-it gjatë rrethit të dytë, ishin dukshëm më pak se sa gjatë rrethit të parë. Megjithatë, përqindja gjatë rrethit të dytë ishte 12%, që ende konsiderohet e lartë.

Pas të dy rrethëve zgjedhore, ankesat zyrtare e paraqitën votimin familjar si parregullësi. Mirëpo, asnjëra nga vendimet e KSHZ-së në lidhje me ankesat, nuk e njohu votimin familjar si shkak për anulimin e rezultateve, edhe pse Neni 151 i Kodit zgjedhor kërkon që KSHZ-ja të anulojë votimin kur “keqpërdoret fshehtësia e votës”, ose “një person ose persona kanë votuar për një person tjetër”.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kodi zgjedhor kërkon që anëtarët e bashkësive etnike të përfshihen në organet e menaxhimit të zgjedhjeve në të gjitha sferat ku do të formojnë 20% të popullatës. Materiali zgjedhor duhet poashtu të prodhohet në gjuhët e pakicave në ato vende. Këto kritere ligjore për përfaqësim “adekuat dhe të drejtë” të bashkësive etnike u arritën në përbërjen e KKZ-ve. Në të gjitha 32 komunat me popullatë lokale të pakicave prej 20% ose më shumë, ose Kryetari i KKZ-ve ose zëvendës Kryetari i takonin grupit përkatës.

Mirëpo, ekzistoi shqetësim tek bashkësitë që paraqesin pak më pak se 20% nga popullata lokale. MVZ i OSBE/ODIHR-it u informua që në ciklet e më parshme zgjedhore, shumica e këtyre bashkësive ishin përfaqësuar edhe në KZ-të, dhe ishin agjedhurrastësisht për pozitave. Kthimi në përpërje të përzier të KZ-ve (profesional/politik), i bëri që të kenë më pak mundësi për marrjen e pozitave në mënyrë të rastsishmë dhe si të tilla ishin më pak të përfaqsuara.

Në nivel nacional, pjesa dërmuese e partive politike që përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike ishin në koalicion me partinë qeveritare VMRO-DPMNE dhe e mbështetën kandidatin presidencial të asaj partie. Në nivel komunal, me procesin në vazhdim të decentralizimit dhe përforcimin e kompetencave të komunave, partitë që përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike kanë më shumë arsye të garojnë të pavarura ose të formojnë koalicione ndryshe prej atyre në nivel nacional. Kështu, u krijua një kolazh kompleks dhe këmbyes i koalicioneve. Sa vjen më shumë, mbështetja e koalicioneve të mësha lidhej me veprimet e premtuara për çështje lokale.

Në mesin e partive politike të bashkësive etnike, Partia demokratike e turqve në Maqedoni (PDTM) pati kandidatët e vet për kryetarë të komunave dhe këshill komunal në tri komuna (Gostivarë, Pllasnicë, Centar Zhupa), kurse Partia demokratike e serbëve në Maqedoni (PDSM) kandidoi kandidatët e vet në dy komuna (Staro Nagoricane dhe Cucer Sandevë), dhe u përkrah nga VMRO-DPMNE-ja. Fijat Canoski, lider i PAE, e cila përfaqëson një bashkësi të vogël të Muslimanëve që flasin maqedonisht, doli si kandidat për kryetar komune në Strugë. Partitë që përfaqësojnë bashkësinë rome kishin dy kandidatë në Komunën e Shkupit Shuto Orizarë. Gjatë rrethit të parë, rreth 33 kandidatë për kryetarë komune përfaqësonin bashkësi tjetër nga ajo e maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik. Dy të tretat e tyre u përkisnin partive që e përfaqësonin grupin e vet etnik, pesë garuan si kandidatë të njëjës nga partitë e mëdha, dhe 6 të tjerë garuan si kandidatë të pavarur. Dy kandidatë për kryetar komune që përfaqësonin bashkësitë etnike fituan gjatë rrethit të parë; kurse shtatë të tjerë arritën deri në rrethin e dytë, prej të cilëve tre u zgjodhën. Kështu, gjithsej 4 kryetarë të komunave që përfaqësojnë bashkësi më të vogla etnike (turke, rome, serbe) u zgjodhën gjatë këtyre zgjedhjeve.

Tensionet ishin të larta gjatë disa fushatave, veçanërisht në komunat ku kandidatët kryesorë i takonin të njëjtës bashkësi etnike (si në Pllasnicë dhe Shuto Orizarë). Në të dyja komunat, u vërejtën parregullësi gjatë procesit të votimit, si dhe gjatë numerimit dhe përlllogaritjes.

Gjatë të dy rretheve, pati raporte të vazhdueshme të frikësimit dhe përpjekje për t'i blerë votat e anëtarëve të bashkësive me status të ulët shoqëror, në veçanti romët.

XII. VËZHGUESIT VENDORË

Gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve, 11 grupe vëzhguesish jopartiak akredituan në KSHZ, gjithsej 6 981 vëzhgues. Përpjekjet më të mëdha për vëzhgim u ndërmor nga Asociacioni vendor MOST, i cili akreditoi 4 520 vëzhgues për rrethin e parë dhe pak më shumë për rrethin e dytë. MOST-i gjithashtu bëri përllogaritje paralele të votave për zgjedhjet presidenciale, për Kryetar të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjet për Këshill. Daja, një organizatë e grave rome, akreditoi 212 vëzhgues mbarë vendit, duke u fokusuar në komunat me numër më të madh të romëve.

Vëzhguesit vendor jopartiak ishin prezent në 77% të vendvotimeve që i vizituan vëzhguesit e MNVZ-së gjatë rrethit të parë dhe 76% gjatë rrethit të dytë. Përveç kësaj, partitë politike dhe kandidatët stacionuan përfaqësues të autorizuar, të cilët ishin prezent në 96% të vendvotimeve që i vizituan vëzhguesit e MNVZ-së më 22 mars dhe 93 % të vendvotimeve të vizituara gjatë rrethit të dytë.

XIII. ANKESAT DHE APELET

Në përgjithësi, ligji përcakton afate të shkurtra për zgjidhjen e ankesave dhe apeleve për mbrojtjen e të drejtës së kandidatëve dhe votuesve (prej 4 deri në 48 orë, varësisht nga shkalla e apelit). Vendimet e lidhura me ankesat dhe procedurat gjyqësore shpallen në ueb-faqen e KSHZ-së ose Gjykatës administrative.

Në qoftë se ndonjë kandidati të mundshëm i pamundësohet regjistrimi, kandidati ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën administrative kundër vendimit të KSHZ-së, KKZ-së ose Komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit, i cili e ka refuzuar kandidimin. Nuk janë parashtruar ankesa formale për regjistrimin e kandidatëve presidencialë. Gjykata administrative është ballafaquar me 12 procese gjyqësore për regjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet lokale - katër prej tyre janë aprovuar dhe gjashtë janë refuzuar, kurse dy tjera janë tërhequr nga parashtruesit. Pesë nga gjashtë proceset e refuzuara janë përjashtuar në bazë procedurale, që mund të tregojë se disa kandidatë nuk kanë pasur njohuri të plotë për të gjitha kërkesat procedurale.

Ankesat nga kandidatët dhe partitë për të drejtat e tyre gjatë periudhës zyrtare të fushatës duhet të parashtrohen në gjykatat e shkallës së parë, kurse ndaj vendimeve të tyre mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën e apelit. Procedura e nenit 73 e Kodit zgjedhor lidhur me mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve, mbetet e paqartë edhe pas ndryshimeve të fundit. Ndonëse Kodi parashih që gjykatat e shkallës së parë (të emëruara si Gjykata themelore) duhet t'i procesojnë rastet e këtilla, dy gjykatat themelore të shkallës së parë në Shkup i kanë deklaruar MVZ të OSBE/ODIHR -it që mbrojtja e të drejtave të kandidatëve nuk ka qenë kompetencë e tyre. MVZ i OSBE/ODIHR nuk ka pasur njohuri për asnjë rast në të cilin kandidatët kanë parashtruar ankesë në gjykatat e shkallës së parë, gjatë periudhës së fushatës.

KSHZ vendosë për ankesat e kandidatëve dhe votuesve lidhur me procedurat zgjedhore, përfshirë edhe fazën e votimit, numërimin dhe përllogaritjes së rezultateve. Ndaj vendimeve të KSHZ-së mundësohet procedura e apelit në Gjykatën administrative. Sipas Kodit zgjedhor,

KSHZ duhet të miratojë Udhëzime për zgjidhjen e ankesave dhe apeleve dhe të vendosë për ankesat në bazë të inspektimit të materialit zgjedhor dhe dëshmime tjera. Megjithatë, ky udhëzim i miratuar e ka kufizuar ngushtë obligimin për inspektimin e materialit zgjedhor, duke e kufizuar atë në rastet kur ankuesi i ka shënuar vërejtjet në formularin zyrtar të trupit zgjedhor.

KSHZ ka ngritur dy procedura të kundërvajtjes kundër partive të vogla në janar në Gjykatën themelore Shkupi I, për shkak të realizimit të fushatës para fillimit të fushatës zyrtare. Njëra procedurë është zgjidhur në prill me vendim në favor të KSHZ-së. Këshilli për radio-difuzion ka ngritur disa procedura kundër transmetuesve të ndryshëm për shkeljen e Kodit zgjedhor dhe rregullave tjera, në masë më të madhe në Gjykatën themelore Shkupi I. Në prill është zgjidhur një rast para-zgjedhor në favor të Këshillit për radio-difuzion. Ndonëse pjesa më e madhe e seancave dëgjimore në rastet e ngritura nga KSHZ ose Këshilli për radio-difuzion janë ricaktuar disa herë, deri në ditën e parë të zgjedhjeve nuk është zgjidhur asnjëri prej tyre. Vonesat e këtilla në veprimet gjyqësore për rastet zgjedhore të lidhura me afate kohore e pengojnë zbatimin e rregullave zgjedhore dhe të drejtën e shpërblimit efektiv të pjesëmarrësve të zgjedhjeve.

XIV. VOTIMI, PËRLLOGARITJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

A. DITA E VOTIMIT - RRETHI I PARË

Marrë në përgjithësi, 22 marsi, dita e zgjedhjeve ka kaluar në paqe dhe qetësi, pa incidentet që i dëmtuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008. Janë shënuar vetëm raste të kufizuara të parregullsisve serioze zgjedhore. Të reshurat e borës para ditës së zgjedhjeve kanë qenë rrezik për parandalimin e votimit në disa pjesë të vendit. Ndonëse Qeveria ka ndërmarrë masa emergjente për hapjen e rrugëve dhe dërgimin e materialit zgjedhor, 134 vendvotime nuk janë hapur, duke e pamundësuar votimin e 12,556 votuesve.

Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgim të zgjedhjeve (MNVZ) e ka mbikëqyrë votimin e parakohshëm vetëm në rrethin e parë të votimit, ku janë përfshirë edhe burgjet, qendrat për personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat që votojnë në shtëpi, një ditë para ditës së zgjedhjeve, ku vlerësimi i përgjithshëm ka qenë pozitiv. Çështjet më të mëdha të raportuara kanë qenë mungesa e shpeshtë e fshehtësisë së votimit në shtëpi dhe mos-sigurimi i materialit zgjedhor gjatë natës. Është problematike që numrat e votuesve nga shtëpia nuk janë regjistruar në formularët e rezultateve të Këshillit zgjedhor. Së këndejmi, këto të dhëna nuk mund të merren në asnjë nivel.

Hapja e vendvotimeve në të dy rrethet zgjedhore është vlerësuar në mënyrë pozitive nga shumica e vëzhguesve, ndonëse janë shënuar disa probleme në aspekt të vjedhjes së kutive të votimit dhe regjistrimit të numrave serik të vulave të kutive të votimit.

Vëzhguesit e MNVZ-së kanë vlerësuar procesin e votimit si të mirë ose shumë të mirë në 95% të vendvotimeve të regjistruara dhe kanë dhënë përshkrim të përgjithshëm si proces i organizuar mirë, në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Vlerësimi ka dalluar mes komunave me shumicë etnike shqiptare (7% negative) dhe pjesës tjetër të vendit (3% negative). Tensione janë shënuar vetëm në disa vende, kurse prania e policisë ka qenë në përgjithësi e organizuar dhe diskrete.

Pa dallim nga vlerësimi i përgjithshëm pozitiv, vëzhguesit e MNVZ-së kanë shënuar disa parregullsi procedurale gjatë procesit të votimit më 22 mars. Votimi familjar, si që ceket paraprakisht, është shënuar si problem i përhapur gjerësisht. Mes tjerash, janë vërejtur edhe problemet e cekura në vijim: votimi i përbashkët (33 raste ose 3%), personi i njëjtë duke i "ndihmuar" disa votues (41 raste ose 4%), përpjekjet për ndikim mbi votuesit (46 raste ose 4%), frikësimi i personave zyrtarë dhe votuesve (8 raste ose 1%), rastet e ndërlydhura të nënshkrimeve me dukje identike në regjistrat e votuesve (19 raste ose 2%) dhe votimi për disa persona (7 raste ose 1%). Në 5% të vendvotimeve të vizituara kutitë e votimit nuk kanë qenë të vulosura në mënyrë të rregullt, në disa raste për shkak se vulat nuk kanë funksionuar si duhet. Vëzhguesit e MNVZ-së kanë raportuar 3 raste të mbushjes së kutive. Ndonëse janë shprehur brenga të ndryshme nga shumë bashkëbisedues para ditës së zgjedhjeve, ka pasur pak raporte për fotografimin e fletëvotimeve të shfrytëzuara për votim nga ana e votuesve.

Prapëseprapë, në 15% të vendvotimeve të vizituara është dhënë vlerësim negativ për numërimin e votave. Procedurat themelore nuk janë respektuar në raste të shpeshta, përfshirë këtu harmonizimin e të dhënave ose kontrollin e numrave serik të sigurimit, para hapjes së kutive të votimit. Një prej pesë vëzhguesve të IEOM-it ka raportuar gabime domethënëse procedurale. Janë raportuar shtatë raste të parregullsive serioze, përfshirë edhe një rast të falsifikimit të qëllimshëm. Shumë këshilla zgjedhorë kanë pasur probleme me plotësimin e formularëve të rezultateve, kurse në një prej gjashtë numërimeve të vëzhguara nuk ka pasur harmonizim të të dhënave të formularëve. Gjysma e këshillave zgjedhorë ku është vëzhguar numërimi nuk e ka bërë shpalljen publike të kopjeve të formularëve të rezultateve, që kërkohet nga Kodi zgjedhor.

B. DITA E VOTIMIT - RRETHI I DYTË

Si edhe në rrethin e parë të votimit, edhe dita e votimit më 5 prill ka qenë në përgjithësi e qetë, në mënyrë të rregullt dhe paqësore, ku janë vërejtur vetëm disa raste të problemeve më serioze. Në shumë aspekte, vlerësimi i vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it dhe PACE-s ka qenë më pozitiv se në rrethin e parë. Vëzhguesit vendas kanë shprehur brengosje për rritjen e raportuar të votimit nga shtëpia në rrethin e dytë.

Procesi i votimit është vlerësuar si i mirë ose shumë i mirë në 97% të vendvotimeve të vizituara, që shënon përmirësim në krahasim me rrethin e parë. Marrë në përgjithësi, vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it dhe PACE-s e kanë përshkruar procesin e votimit si të organizuar, të qetë dhe të rregullt. Për dallim nga rrethi i parë, në vlerësimin e përgjithshëm nuk ka pasur dallime të dukshme rajonale. Janë vërejtur tensione në disa vende, posaçërisht aty ku dallimi mes garuesve për kryetar komune ka qenë i ngushtë. Policia sërish ka qenë e organizuar mirë dhe diskrete. Edhe përkrah vlerësimit të përgjithshëm pozitiv, janë shënuar disa shkelje procedurale të ngjashme me rrethin e parë - në përgjithësi, në nivel më të ulët.

Marrë në përgjithësi, numërimi i votave është vlerësuar si pozitiv në 61% vendvotime të vëzhguara, ku vetëm katër numërime janë vlerësuar si të këqija dhe një si shumë i keq. Ndonëse vlerësimi i përgjithshëm ka qenë më i mirë se në rrethin e parë, janë vërejtur disa probleme, që sërish janë lidhur me përmbajtjen ndaj procedurave dhe saktësinë e numërimit. Si edhe në rrethin e parë, vëzhguesit kanë raportuar që procedurat themelore të harmonizimit shpesh herë nuk janë respektuar, veçanërisht para hapjes së kutive të votimit. Ka pasur tre raste ku janë shënuar parregullsi më serioze. Në më tepër se gjysmën e vendvotimeve të vëzhguara, këshillat zgjedhorë sërish kanë dështuar në shpalljen e formularëve të rezultateve të vendvotimeve.

C. PËRLLOGARITJA - RRETHI I PARË

IEOM e ka vëzhguar përllogaritjen e rezultateve në 44 komuna, duke qenë e pranishme gjatë natës së votimit në pjesën më të madhe të komunave të cekura. Procesimi në nivel të Këshillave komunalë zgjedhorë (KKZ) është vlerësuar si i mirë ose shumë i mirë në 86% të KKZ-ve të vëzhguara. Në të shumtën e rasteve, procesi ka qenë i organizuar mirë dhe në përgjithësi, formularët e rezultateve të këshillave zgjedhorë janë kontrolluar gjatë pranimit. Megjithatë, procesi në disa KKZ është vlerësuar si i çorganizuar.

Vëzhguesit e MNVZ-së kanë raportuar për disa probleme të lidhura me transparencën e procesimit në KKZ - vëzhgimi i shënimit elektronik të të dhënave në të shumtën e rasteve i është lejuar vetëm vëzhguesve të MNVZ-së, por jo edhe vëzhguesve vendor ose përfaqësuesve të partive politike.

D. PËRLLOGARITJA - RRETHI I DYTË

Në rrethin e dytë, vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it dhe PACE-s e kanë përcjellë procesin e përllogaritjes në 39 KKZ nga gjithsej 84, me vlerësim pozitiv, me përjashtim të një KKZ në Tetovë. KKZ në fjalë është vlerësuar më pak pozitivisht për arsye të procesimit të ngadalshëm, që ka ardhur si pasojë e përpjekjeve të KKZ-së për shmangien e problemeve të shënuara në rrethin e parë, që ka rezultuar me rinumërimin e votimit për këshillin komunal në 19 vendvotime.

Si edhe në rrethin e parë, janë vërejtur disa probleme me transparencën e përllogaritjes, kryesisht të lidhura me mundësinë e vëzhguesve për vëzhgimin e regjistrimit të të dhënave të rezultateve. Megjithatë, asnjë vëzhgues i OSBE/ODIHR-it dhe PACE-s nuk ka dhënë vlerësim negativ për transparencën e përgjithshme të procesit. Përveç kësaj, shumica e vëzhguesve e kanë vlerësuar punën e KKZ-ve në mënyrë pozitive.

E. SHPALLJA E REZULTATEVE

KSHZ ka filluar me shpalljen e rezultateve paraprake të zgjedhjeve në natën e 22 marsit dhe i ka publikuar ato në ueb-faqe, pa i shpallur të njëjtat në vendvotime, ndonëse kjo ishte paralajmëruar paraprakisht.¹⁴ Rezultatet përfundimtare të rrethit të parë janë shpallur më 3 prill.

Meqë asnjë kandidat presidencial nuk e fitoi shumicën e votave nga të gjithë votuesit e regjistruar në rrethin e parë më 22 mars, Gjorge Ivanov (VMRO-DPMNE) dhe Ljubomir Frçkoski (SDSM) si kandidatë me shumicën e votave, garuan në rrethin e dytë më 5 prill. Gjatë rrethit të dytë, KSHZ filloi me shpalljen dhe vendosjen e rezultateve paraprake të zgjedhjeve presidenciale dhe lokale në ueb-faqe gjatë mbrëmjes, për çdo vendvotim. KSHZ i shpalli rezultatet paraprake më 6 prill, kurse më 13 prill u publikuan edhe rezultatet finale.

Sipas KSHZ-së, në zgjedhje kanë dalë 42.63% e votuesve të regjistruar, ku Gjorge Ivanov ka fituar 63.14% të votave, kurse Ljubomir Frçkoski ka marrë 36.86%. Dalja në zgjedhje në nivel prej 42.63% përfshinte në vete edhe një numër domethënës të fletëvotimeve të

¹⁴ Rezultatet në nivel të vendvotimeve janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së më 24 mars në ora 00:30.

pavlefshme (5.96% të votave, për dallim nga 3.18% në rrethin e parë).¹⁵ Meqë dalja në zgjedhje ishte mbi kufirin prej 40%, KSHZ e miratoi vendimin për shpalljen e Gjorge Ivanovit si President të zgjedhur.

Meqë mandatet e zgjedhjeve lokale mund të ndikohen nga disa vota, çështjet të cilat nuk kanë pasur ndikim në zgjedhjet presidenciale (si që është prishja e votimit në vendvotime dhe moti i keq) e kanë detyruar organizimin e votimit plotësues në 124 vendvotime më 22 mars. Gjithsej, tetë gara për kryetar komune dhe mandatet e 23 këshillave komunalë kanë garuar në zgjedhjet e 5 prillit. Në vazhdim, në pesë komuna ka pasur rreth të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune më 19 prill dhe për shkak të prishjes së votimit, në një vendvotim është rivotuar më 3 maj. Rezultatet finale të zgjedhjeve lokale nuk janë shpallur në ueb-faqen zyrtare të KSHZ-së deri në fund të qershorit 2009.

XV. DITA E ZGJEDHJEVE NË ASPEKT TË ANKESAVE DHE APELEVE

KSHZ ka pranuar gjithsej pesë ankesa nga votuesit, të lidhura me të drejtën e votës - katër prej tyre gjatë rrethit të parë dhe një gjatë rrethit të dytë. KSHZ i ka zgjidhur të gjitha pesë rastet brenda afatit ligjor.

Megjithatë, KSHZ nuk i ka procesuar brenda afatit ligjor 82 ankesat e pranuar nga parashtruesit e listave për rrethin e parë të votimit, që e ka prolonguar shpalljen e rezultateve finale të rrethit të parë, duke i komplikuar parapërgatitjet për rrethin e dytë. Pas rrethit të dytë të zgjedhjeve, KSHZ i ka zgjidhur të gjitha 96 ankesat e pranuar brenda afatit ligjorë, në një mënyrë më të organizuar.

KSHZ ka aprovuar vetëm tetë nga 82 ankesat e pranuar për rrethin e parë të votimit - një të BDI-së, tre të VMRO-DPMNE-së dhe katër të LSDM-së. Gjashtë prej tyre kanë rezultuar me prishjen e rezultateve të një qendre votimi të zgjedhjeve lokale. Një ankesë tjetër e aprovuar nga KSHZ ka qenë e lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve të zgjedhjeve lokale në 19 vendvotime në Tetovë, ku janë bërë përmirësime jologjore në formularët e këshillit zgjedhor. Si pasojë e rinumërimit të KSHZ-së, ka ndryshuar ndarja e mandateve në këshillin komunal në Tetovë.

KSHZ ka aprovuar vetëm 2 nga 96 ankesat e pranuar në rrethin e dytë - një të BDI-së dhe një të PEI-t. KSHZ e ka prishur një vendvotim në Haraçinë, për shkak të dy fletëvotimeve tepëricë në kutinë e votimit për zgjedhjet e kryetarit të komunës. Prapëseprapë, në rinumërimin e Gjykatës Administrative, në bazë të procesit gjyqësor të iniciuar nga partia Demokracia e Re, nuk është gjetur mospërputhje mes numrit të fletëvotimeve dhe numrit të votuesve që kanë votuar, me çka u anulua vendimi i KSHZ-së.

Të gjitha seancat zyrtare të KSHZ-së për shqyrtimin e ankesave kanë qenë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e parashtruesve të listave kanë pasur mundësi të marrin pjesë. KSHZ nuk e ka inspektuar tërë materialin zgjedhor të vendvotimeve të cekura në ankesa, duke e bazuar vendimin e vet kryesisht në formularët e këshillave zgjedhorë. Në disa raste, KSHZ ka kërkuar që tërë materiali zgjedhor të silltet në Shkup për inspektim, përfshirë edhe fletëvotimet. Si që ceket paraprkisht, duket që KSHZ e ka interpretuar në mënyrë të ngushtë obligimin e saj ligjor për zgjidhjen e ankesave në bazë të inspektimit të materialit zgjedhor

¹⁵ Fletëvotimet e pavlefshme nuk kanë ndikuar në kufirin e përkufizuar, meqë numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme ka qenë mbi kufirin e daljes prej 40%.

(Neni 31.2.35 i Kodit zgjedhor). Në të shumtën e rasteve KSHZ ka vendosur për mospranimin e ankesave në qoftë se ato nuk janë shënuar në formularin e rezultateve të këshillave zgjedhorë, gjë që nuk kërkohet nga ligji, por është bërë sipas kërkesës së tyre.

Ka pasur disa mospërputhje në vendimet e KSHZ-së për inspektimin e tërë materialit zgjedhor. Për shembull, votimi në tre vendvotime në Komunën e Dollnenit është anuluar në rrethin e parë, pas numërimit të fletëvotimeve të këtyre vendvotimeve për zgjedhjet e kryetarit të komunës nga ana e KSHZ-së, e cila konstatoi që numri i fletëvotimeve të shfrytëzuara e tejkalon numrin e votuesve të nënshkruar në regjistrin e votuesve. Por, gjatë shqyrtimit të formularëve të rezultateve për zgjedhjet e këshillave komunalë nga vendvotimet e njëjta, KSHZ vendosi (përgjatë linjave partiake) kundër rinumërimit dhe prishjes, ndonëse mospërputhjet e njëjta kanë ndodhur edhe për zgjedhjet e kryetarit të komunës.

KSHZ e ka refuzuar ankesën në rrethin e parë të Partisë për emancipim të plotë të romëve, logoja e së cilës në fletëvotimet për këshilla komunalë në katër komuna është zëvendësuar gabimisht me logon e një partie tjetër rome, me arsyetim që gabimi është bërë nga shtëpia e botimit. Sipas Kodit zgjedhor, KSHZ është përgjegjëse për konfirmimin e faqosjes finale të fletëvotimeve.

Seancat e Gjykatës administrative për proceset gjyqësore të lidhura me zgjedhjet nuk kanë qenë të hapura për publikun, përveç shpalljes së përmbajtjes së procesit gjyqësor, ndonëse Kodi zgjedhor e kërkon vendim-marrjen në seancë publike. Inspektimi i materialit zgjedhor, diskutimi dhe vendim-marrja në proceset gjyqësore nuk ka qenë publik. Në gjyq janë ngritur 52 procedura gjyqësore kundër vendimeve të KSHZ-së në rrethin e parë dhe 47 në rrethin e dytë - është aprovuar vetëm një procedurë e ngritur nga Demokracia e Re për Haraçinën. Gjykata administrative i ka publikuar vendimet në ueb-faqe.

XVI. REKOMANDIMET

Rekomandimet në vijim i ofrohen për shqyrtim organeve kompetente, partive politike dhe shoqërisë civile në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si përkrahje e mëtejshme e përpjekjeve të tyre për realizimin e zgjedhjeve në pajtim të plotë me përkushtimet e OSBE-së dhe standardeve tjera për zgjedhje demokratike. Disa rekomandime tashmë janë dhënë edhe në raportet paraprake finale të OSBE/ODIHR-it, që duhet të trajtohen. Përveç rekomandimeve të reja të këtij raporti, në veçanti duhet të trajtohen rekomandimet e raportit final të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parakohshme parlamentare të vitit 2008, të cilat ende nuk janë implementuar. OSBE/ODIHR mbetet e gatshme për sigurimin e përkrahjes për përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor.

A. BALLAFAQIMI ME PRESIONIN OSE FRIKËSIMIN E VOTUESVE

1. Organet kompetente duhet ta shqyrtojnë ndërmarrjen e hapave të fuqishëm për ballafaqimin me të gjitha format e presionit ose frikësimit të votuesve, që ka qenë problemi më serioz i identifikuar nga MVZ i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2009. Në veçanti, zyrtarët e lartë publikë, ku theksohet përfshirja e ministrave qeveritarë dhe udhëheqësve të agjencive publike, institucioneve dhe kompanive, kanë mund të japin deklaratatë qarta publike dhe të lëshojnë instruksione me shkrim para dhe gjatë periudhës së fushatës që nuk do të tolerohet asnjë presion mbi nëpunësit publikë dhe që asnjë i punësuar ose qytetar nuk duhet të frikohet për vendin e punës, ndihmën pensionale ose sociale për shkak të mbështetjes ose përkrahjes së ndonjë

partie politike ose kandidatit të caktuar. Përveç kësaj, rastet e frikësimit të qytetarëve të regjistruara nga policia dhe organet tjera të zbatimit të ligjit duhet të hetohen dhe procesohen në mënyrë të detajuar.

2. Duhet të ndërmerren hapa për depolitizimin e administratës publike dhe profesionalizimin e shërbimit publik, me qëllim të mbrojtjes së nëpunësve publik nga presioni politik. Këto masa duhet të aplikohen për nëpunësit publikë dhe të gjithë të punësuarit tjerë publikë dhe të punësuarit në agjencitë dhe ndërmarrjet publike. Është e këshillueshme që kjo mbrojtje të pasqyrohet edhe në kontratën e punësimit të nëpunësve publike, mundësisht edhe në një kartë të posaçme etike të nëpunësve publikë.

B. KORNIZA LIGJORE

3. Kodi zgjedhor dhe aktet relevante nënligjore, si që janë udhëzimet e KSHZ-së do të përfitojnë nga shqyrtimi i detajuar dhe ndryshimet për harmonizimin e dispozitave dhe për shmangien e zbrazëtirave dhe kundërthënieve brenda legjislativës dhe ndaj zbatimit praktik. Në rrethana ideale, shqyrtimi i këtillë do ta përfshijë procesin e hapur të konsultimeve publike. Disa shembuj të zbrazëtirave ekzistuese ose kundërthënieve i përfshijnë aspektet e cekura në vijim:¹⁶

- Kodi zgjedhor nuk qartëson saktë se cilat aktivitete politike lejohen dhe cilat nuk lejohen para fillimit të fushatës zyrtare;
- Kodi zgjedhor nuk shprehet qartë nëse partitë dhe kandidatët duhet ta dorëzojnë listën e përfaqësuesve të autorizuar në KKZ - nëse po, cilat janë afatet dhe ndëshkimet e mundshme që mund të zbatohen për dështimet në dorëzimin e listave të këtilla;
- Kodi zgjedhor nuk cek se çka ndodh në qoftë se kandidati vendosë të tërhiqet nga zgjedhjet mes rrethit të parë dhe rrethit të dytë zgjedhor;
- Neni 37 i Kodit zgjedhor është në konflikt me nenin 148.1, në aspekt të kompetencave për vendim-marrje ndaj ankesave;
- Neni 63.2 i Kodit zgjedhor nuk e qartëson procedurën për mbledhjen e nënshkrimeve gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve në zyrat rajonale të Ministrisë së drejtësisë.

4. Kufiri ligjor i 40% i daljes në zgjedhje në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale mund të rishqyrtohet dhe të mënjanohet, për shkak se krijon hapësirë për dështimin e zgjedhjeve. Në qoftë se vështrohet si e vlefshme për besueshmërinë e procesit zgjedhor, kufiri i këtillë rekomandohet vetëm për rrethin e parë.
5. Kodi zgjedhor mund ta qartësojë autoritetin dhe mandatin e Këshillit për radio-difuzion për rregullimin e mbulimit mediatik të aktiviteteve politike mes datës kur shpallen zgjedhjet dhe datës së fillimit zyrtar të fushatës. Ky autoritet dhe mandat duhet të jetë në pajtim me legjislativën tjetër, si që është Ligji për punë radio-difuzive.
6. Dispozitat e Kodit zgjedhor për financimin e fushatës mund të ndryshohen për ta siguruar mbikëqyrjen e mirëfilltë të rregullave të financimit dhe caktimit të limiteve

¹⁶ Shikoni edhe pjesën e subjekteve të posaçme në vijim për rekomandimet plotësuese për përmirësimet e Kodit zgjedhor.

efektive për donacionet dhe shpenzimet, si dhe për qartësimin e procedurave të raportimit dhe auditimit. Këtu në veçanti përfshihen:

- Neni 83 dhe 84 i Kodit zgjedhor mund të rishqyrtohet në aspekt të anulimit të përjashtimeve për limitet e donacioneve për fushatat, që duket se e pengon qëllimin e ligjit;
- Procedura për refuzimin e kthimit të mjeteve të kandidatëve, në bazë të nenit 87 të Kodit zgjedhor, mund të qartësohet;
- Kodi zgjedhor ose rregullativat mund ta cekin qartë përmbajtjen dhe formatin e raporteve financiare që dorëzohen nga kandidatët. Në veçanti, forma aktuale e caktuar nga Ministria e financave nuk kërkon nga kandidatët të dorëzojnë informata për shpenzimet, me çka pengohet transparenca dhe dobia e raportimit të këtillë;
- Procedura e auditimit mund të avancohet, me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes së financave të të gjithë kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhje;
- Neni 86 i Kodit zgjedhor, ku parashihet kthimi i mjeteve të shpenzuara për fushatën e kandidatëve që kanë fituar, mund të shqyrtohet dhe mundësisht të zëvendësohet me sistemin i cili ia jep të drejtën e kthimit të mjeteve të gjithë kandidatëve që kanë fituar përqindje të caktuar të votave. Përqindja e këtillë mund të jetë në lartësi të mjaftueshme për ta siguruar popullaritetin e kandidatëve, por edhe mjaft të ulëta për të dhënë nxitje të gamës së gjerë të kandidatëve, posaçërisht të femrave dhe anëtarëve të bashkësive më të vogla etnike, që ndonjëherë ballafaqohen me vështirësi në mbledhjen e mjeteve të nevojshme për fushatë të fuqishme.

C. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

7. Organet kompetente mund t'i shqyrtojnë mënyrat për sigurimin e kuadrit të kualifikuar profesionist, burimeve dhe hapësirës së punës për KSHZ-në. Përveç nevojës për kuadër të rregullt profesional, KSHZ ka nevojë për kuadër dhe burime të mjaftueshme për zbatimin e përgjegjësive të reja, në aspekt të listave zgjedhore dhe votimit në mbarë vendin.
8. Administrata efektive zgjedhore mund të përfitojë shumë nga miratimi i rregullativave të gjera për udhëheqjen e procesit zgjedhor dhe për mbulimin e të gjitha zbrazëtirave dhe mospërputhshmërive në Kodin zgjedhor. Rregullativat ideale në vete ndërtojnë udhëzime të qarta, praktike dhe të detajuara për procedurat e këshillit zgjedhor për hapjen, votimin, numërimin dhe plotësimin e formularëve të rezultateve dhe në veçanti për harmonizimin e numrave të formularëve. Më tej, rregullativa mund të jep udhëzime praktike dhe të detajuara për punën e KKZ-së në ditën e zgjedhjeve, duke e përfshirë pranim-dorëzimin, verifikimin dhe harmonizimin e formularëve të rezultateve, udhëzimin për rinumërim dhe udhëzimin e qartë për kompjuterizimin e rezultateve të këshillave zgjedhorë. Në këtë mënyrë, Doracaku i KKZ -së do të përmirësohet në masë të madhe përmes përdorimit të gjuhës së qartë dhe direkte, në vend të përsëritjes së dispozitave të Kodit zgjedhor.
9. Ekziston hapësirë për përmirësimin e trajnimit të KKZ-ve dhe këshillave zgjedhorë. Në veçanti, përqendrim më i madh mund t'i jepet procedurave të përlogaritjes, kompletimit të formularëve të rezultateve dhe procesit të numërimit në nivel të KKZ-së. Duhet të shqyrtohet mundësia e trajnimit të KKZ-ve dhe këshillave zgjedhorë në mënyrë më interaktive.

10. Edukimi i votuesve duhet të rritet në vëllim, afat kohor dhe cilësi. Edukimi i votuesve duhet t'i synojë brengat konkrete që janë identifikuar në zgjedhjet e fundit, përfshirë frikësimin dhe shtrëngimin, fshehtësinë e fletëvotimit, të drejtat e votuesve dhe votimin familjar.

D. REGJISTRIMI I VOTUESVE

11. Auditimi dhe revidimi i detajuar i listave të votuesve është dashur të ndodhë shumë më herët. Kjo mund të rezultojë me lista shumë më të mira, duke i mënjanuar regjistrimet e dyfishta dhe ato të personave të vdekur, njëherazi duke i trajtuar edhe mangësitë tjera, përfshirë edhe problemin e qytetarëve që gjenden jashtë vendit, emrat e të cilave nuk cekën si të këtilla në listat e votuesve. Hap qenësor për krijimin e besimit të gjerë publik në cilësinë e listave do të shënohej nëse procedurat e reviduara diskutohen dhe adoptohen me përfshirje të gjerë, në proces publik mes të gjithë palëve të përfshira në zgjedhje, veçanërisht të partive politike.

E. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

12. Mund të shqyrtohet kufizimi për mbështetjen e vetëm një kandidati nga qytetarët për zgjedhjet. Procesi do të jetë shumë më i hapur dhe përfshirës, nëse qytetarët nënshkruhen për të gjithë kandidatë të cilët dëshirojnë t'i përkrahin. Dispozita e këtillë mund ta rrisë besimin e votuesve dhe fshehtësinë e votës, meqë nënshkrimi për një kandidat të caktuar nuk do të shihet patjetër si përkrahje vetëm për një kandidat.
13. Mund të shqyrtohet kërkesa që mbledhja e nënshkrimeve të realizohet në zyrat lokale ose rajonale të Ministrisë së drejtësisë, në aspekt të pohimeve nga disa kandidatë që paraqitja para zyrtarëve qeveritarë për dhënien e nënshkrimit në mbështetje të kandidatit të opozitës, mund të vështrohet nga qytetarët si frikësim. Një alternativë është që t'i lejohet kandidatëve dhe partive ta organizojnë vetë mbledhjen e nënshkrimeve, por në këtë rast, KSHZ duhet të ngarkohet me detyrën e verifikimit të nënshkrimeve, mundësisht duke e përdorur ekzemplarët e rastësishëm.

F. FUSHATA ZGJEDHORE

14. Partitë politike dhe kandidatët, në veçanti kandidatët presidencialë, mund të përpiqen më tepër për shpjegimin e politikave të tyre dhe qasjen ndaj bashkësive tjera etnike.
15. Procesi i fushatës do të përmirësohet nëse komunat e plotësojnë në mënyrë të rreptë obligimin për caktimin e vendeve për shpalljen e posterëve të fushatës, në afatin e caktuar kohorë dhe në vendet e caktuara me gjerësi të mjaftueshme, të dukshme dhe adekuate për posterët.

G. MEDIAT

16. Në qoftë se rregullohet mbulimi politik nga mediat gjatë periudhës para fushatës për sigurimin e mbulimit të barabartë të të gjithë kandidatëve, rregullativat nuk duhet t'i pengojnë mediat nga sigurimi i mbulimit normal të zhvillimeve politike.
17. Mund të caktohen afate më të shkurtra për vendim-marrje në proceset gjyqësore të ngritura nga Këshilli për radio-difuzion kundër transmetuesve, gjatë periudhës së

fushatës dhe para-fushatës. Në këtë mënyrë, sigurohet që Këshilli për radio-difuzion i zbaton rregullativat me kohë dhe lejohet mundësia për zhdëmtim të shpejtë dhe efektiv të transmetuesve, në rast se të drejtat e tyre janë shkelur.

18. Me qëllim të vazhdimin me funksionimin efektiv, Këshilli për radio-difuzion duhet të pranojë përkrahje të vazhdueshme dhe adekuate nga qeveria, si dhe financim, për ta mbajtur pavarësinë qenësore. Parlamenti duhet ta plotësojë përgjegjësinë që e ka për ta siguruar emërimin e hershëm të të gjithë anëtarëve të Këshillit për radio-difuzion.

H. VOTIMI, NUMËRIMI, PËRLOGARITJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

19. Numri i votuesve që votojnë nga shtëpia duhet të përfshihet në formularët e rezultateve të këshillave zgjedhorë dhe KKZ-ve, që gjithashtu mund të jepen për qasje edhe në nivel nacional, me qëllim të rritjes së transparencës dhe sigurimit të mbrojtësve plotësues nga shpërdorimet e mundshme zgjedhore. Fshehtësia e fletëvotimit të votuesve nga shtëpia duhet të sigurohet nga këshillat zgjedhorë.
20. Duhet të trajtohet edhe ndryshimi i ligjit në aspekt të lejimit të zëvendësimit të fletëvotimeve, të cilat votuesit i kanë prishur me qëllim. Në këtë rast, duhet të ekzistojë rregullativa gjegjëse për këto raste.
21. Kodi zgjedhor mund të ndryshohet dhe të cekët që në rastet kur numrat serik të vulave të kutive të votimit të shënuara para numërimit të votimit nuk përputhen me numrat pas vulosjes së kutisë, votimi në këto vendvotimet duhet të prishet automatikisht dhe zgjedhjet duhet të përsëriten. Mund të shqyrtohet edhe mundësia e obligimit të KSHZ-së për hetimin e rasteve të këtilla sipas detyrës zyrtare.
22. Përpjekje të mëtejshme për parandalimin e parregullsive, si që është votimi familjar, votimi i përbashkët, ndihma e një personi për më tepër se dy votues, përdorimi i telefonave celularë dhe kamerave për fotografimin e fletëvotimeve të shënuara. Kodi zgjedhor dhe/ose rregullativat e KSHZ-së duhet t'i cekin qartë sanksionet e parapara për votuesit dhe anëtarët e këshillit zgjedhor. Trajnimi i anëtarëve të këshillave zgjedhorë në ardhmëri duhet ta përfshijë edhe trajtimin e parregullsive të këtilla, në më tepër detaje. Nevojitet edhe vazhdimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes publike.

I. ANKESAT DHE APELET

23. Procedurat e ankesave dhe ato gjyqësore mund të avancohen edhe më tej, me qëllim të shmangies së zbrazëtirave dhe mospërputhshmërive në vendim-marrje, si në vijim:
 - Kodi zgjedhor mund të qartësojë në qoftë se Ligji i përgjithshëm për procedurë administrative (që në disa vende ndeshet me Kodin zgjedhor) aplikohet në procesin e vendim-marrjes tek ankesat e lidhura me zgjedhjet. Mund të ndërmerren përpjekje për harmonizimin e legjislacionit të këtillë;
 - Kodi zgjedhor mund t'i caktojë afat KSHZ-së për propozimin zyrtar të prishjes së zgjedhjes;
 - Kodi zgjedhor ose rregullativat mund të qartësojnë nëse ankesat mund të dërgohen me faks (sipas Kodit zgjedhor, nuk lejohet dërgimi me postë). Kjo është posaçërisht e rëndësishme në aspekt të mbrojtjes të të drejtave të votuesve në ditën e zgjedhjeve;

- Kodi zgjedhor mund të qartësojë se në cilat raste obligohet KSHZ-ja për inspektimin e materialit zgjedhor gjatë shqyrtimit të ankesave, me qëllim të nxitjes së qasjes më hetuese të KSHZ-së. Nëse qëllimi i ligjit ka qenë mundësimi i inspektimit të materialit zgjedhor vetëm në rast të vërejtjeve të regjistruara në formularët e rezultateve të këshillave zgjedhorë dhe KKZ-ve, kjo duhet të ceket qartë në Kodin zgjedhor;
 - Kodi zgjedhor mund të përcaktojë qartë se kush lejohet të parashtrojë procedura ligjore kundër vendimeve të KSHZ-së dhe t'i caktojë kornizat kohore relevante.
24. Kodi zgjedhor ose legjislacioni tjetër mund të caktojë korniza të qarta dhe të shkurtra kohore për vendim-marrje gjyqësore për procedurat e kundërvajtjes në rastet e lidhura me zgjedhjet, të ngritura nga KSHZ, me qëllim të sigurimit të zbatimit të rregullave zgjedhore në kohën e duhur dhe të të drejtës së pjesëmarrësve në zgjedhje për shpërblim efektiv.

J. PJESËMARRJA E FEMRAVE

25. Nevojiten përpjekje të mëtejshme nga organet menaxhuese të zgjedhjeve, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile për t'i dhënë fund praktikës së votimit familjar.
26. Mund të trajtohet edhe ndryshimi i nenit 64.5 të Kodit zgjedhor, që të sigurohet zëvendësimi i femrës që tërhiqet nga lista e kandidatëve të këshillit komunal me femrën e ardhshme në listë.
27. Me qëllim të avancimit të pjesëmarrjes së femrave në strukturën e partive politike, organet kompetente duhet ta zbatojnë nenin 18 të Ligjit për mundësi të barabarta për meshkujt dhe femrat, sipas të cilit kërkohet nga partitë politike që në çdo dy vite të hartojnë "plan për mundësi të barabarta" ku ceken metodat dhe masat, që do të aplikohen për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në trupat e partisë dhe listat e tyre kandiduese.

K. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

28. Fletëvotimet e shtypura për njësitë e vetëqeverisjes lokale me të paktën 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare, ndryshe nga gjuha maqedonase dhe që i përmbajnë të gjitha informatat në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e bashkësive gjegjëse, mund të ridisajnohen, me qëllim që numrat rendorë të kandidatëve (ose listat e kandidatëve) të përfshihen vetëm një herë, në vend se ndaras për çdo gjuhë. Kjo do ta thjeshtojë pamjen e fletëvotimit, do ta rrisë fshehtësinë e votës dhe mund ta zvogëlojë numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.
29. Pohimet e vazhdueshme për blerjen e votave, posaçërisht në vendbanimet romë duhet të trajtohen nga organet kompetente, përmes edukimit të votuesve dhe ndjekjes ligjore.

L. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

30. Kodi zgjedhor ose rregullativat zgjedhore duhet të cekin qartë se vëzhguesit vendas dhe të huaj kanë të drejtë t'i marrin kopjet e të gjitha formularëve të rezultateve të këshillave zgjedhorë dhe KKZ-ve, jo vetëm të pjesës së përllogaritjes.

31. KSHZ dhe KKZ-të duhet ta zbatojnë kërkesën që këshillat zgjedhorë t'i shpallin publikisht kopjet e formularëve të numërimit, menjëherë pas përfundimit të numërimit.

ANEKS: REZULTATET E ZGJEDHJEVE

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

Hyrje në protokollin e rezultateve të KSHZ-së	Numri	
	Rrethi 1	Rrethi 2
Numri i përgjithshëm i votuesve në listën e votuesve	1,792,082	1,792,082
Numri i vendvotimeve të cilat raportuan rezultate	2,845	2,975
Përqindja e vendvotimeve të cilat raportuan rezultate	95.60%	99.97%
Numri i votuesve që kanë votuar	1,019,268	764,029
Përqindja e votuesve që kanë votuar (krahasuar me numrin e votuesve të regjistruar)	56.88%	42.63%
Përqindja e votuesve që kanë votuar (krahasuar me numrin e votuesve të regjistruar në vendvotimet që raportuan)	56.88%	42.63%
Numri i fletëvotimeve të vlefshme	986,882	718,450
Numri i fletëvotimeve të pavlefshme	32,386	45,589
Numri i fletëvotimeve të pa përdorura	772,814	1,028,043

Kandidati	Rrethi 1		Rrethi 2	
	Votat e marra	Përqindja e votave vlefshme	Vota të marra	Përqindja e votave vlefshme
Imer Selmani	147,547	14.95%		
Mirushe Hoxha	30,225	3.06%		
Nano Ruzhin	40,042	4.06%		
Gjorge Ivanov	345,850	35.04%	453,616	63.14%
Ljube Boshkoski	146,878	14.88%		
Agron Buxhaku	73,629	7.46%		
Ljubomir Frckoski	202,691	20.54%	264,828	36.86%

[Burimi: Ueb faqja e KSHZ-së (<http://www.sec.mk:90/2009>)]

ZGJEDHJET LOKALE (JOZYRTARISHT)

Partia/Koalicioni	Numri i fituar i kryetarëve të komunave
VMRO-DPMNE	56
BDI	14
LSDM	6
PDSH	1
Demokracia e re	1
Partia Demokratike e turqve në Maqedoni	1
Aleanca e romëve	1
Partia radikale e serbëve në Maqedoni	1
Koalicioni LSDM, PDL, PRSD	1
Koalicioni BDI dhe Lëvizja për unitet kombëtar e turqve	1
Kandidatë të pavarur	2

ZGJEDHJET PËR KËSHILLE KOMUNALE (JOZYRTARISHT)

Partia/Koalicioni	Numri i përgjithshëm i vendeve të fituara në Këshill
VMRO–DPMNE	460
LSDM	282
BDI	179
Demokracia e re	61
PDSH	52
VMRO popullore	42
PLD	29
PRSD	20
Koalicioni LSDM, PDL	18
Partia e demokratëve të bashkuar në Maqedoni	18
Partia demokratike e turqve në Maqedoni	16
Koalicioni VMRO–DP, TMRO–VEP	12
PAE	10
Lista të tjera të kandidatëve	192

RRETH OSBE/ODIHR-së

Zyra për Institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon shteteve “për të siguruar respekt të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, t’i përmbahen sundimit të ligjit, të promovojnë principet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, përforcojnë dhe t’i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancë nëpërmjet shoqërisë” (1992, Dokument i Samitit të Helsinkit). Kësaj i referohet si dimensionin njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua si zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua që të reflektojë mandatin e zgjeruar meqë i përfshiu edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ka një staf punues prej 130 vetëve.

OSBE/ODIHR është Agjencion udhëheqës në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, bën koordinimin dhe organizon vendosjen e mijëra vëzhguesve për vlerësimin nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së janë mbajtur në pajtim me Detyrimet e OSBE-së, standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionit nacional. Metodologjia e tyre unike siguron depërtim të thellë në procesin zgjedhor në tërësi. Nëpërmjet projekteve për ndihmë, OSBE/ODIHR u ndihmon shteteve pjesëmarrëse të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetje të legjislacionit, udhëheqje demokratike, migracion dhe të drejtën e lëvizjes së lirë dhe barazi gjinore. OSBE/ODIHR zbaton një numër të programeve të planifikuara për asistencë gjatë vitit, me qëllim të zhvillimit të strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR gjithashtu i ndihmon shtetet pjesëmarrëse në plotësimin e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që përmbahen në përkushtimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së. Kjo arrihet duke punuar me partnerë të ndryshëm në drejtim të kultivimit të bashkëpunimit, ndërtimit të kapacitetit dhe sigurimit të ekspertizës në fusha tematike duke përfshirë të drejtat e njeriut gjatë luftës kundër terrorizmit, rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, arsimim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, vëzhgim dhe raportim mbi të drejtat e njeriut, si dhe të drejtat e njeriut të grave dhe sigurisë.

Në fushën e **tolerancës** dhe **jo-diskriminimit**, OSBE/ODIHR u siguron mbështetje shteteve pjesëmarrëse në përforcimin e përgjigjes së tyre ndaj krimit të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit, dhe formave të tjera të mos-tolerancës.

Aktivitetet e OSBE/ ODIHR-së në lidhje me tolerancën dhe mos-diskriminimin fokusohen në fushat që vijojnë: legjislacioni, trajnime për zbatim të ligjit, monitorim, raportim dhe ndjekje të përgjigjes ndaj krimeve dhe incidenteve të shtyra nga urrejtja; si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit reciprok.

OSBE/ODIHR i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikën e tyre ndaj Romëve dhe Sintit. Bën promovimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe rrjeteve midis komuniteteve të Romëve dhe Sintit, dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Romëve dhe Sintive në organet ku krijohen politikën.

Të gjithë aktivitetet e ODIHR-së zhvillohen me koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, Institucionet e OSBE-së dhe operacioneve në teren, si dhe me organizatat të tjera ndërkombëtare.

Për më shumë informata, e keni në dispozicion ueb faqen e ODIHR-së: (www.osce.org/odihr).